

# PËRTEJ KRYETITUJVE MANUAL PËR GAZETARËT QË RAPORTOJNË PËR ÇËSHTJET E SIGURISË, ARMËT E VOGLA E TË LEHTA DHE DHUNËN ME BAZË GJINORE NË SHQIPËRI

Asistencë për autoritetet e Republikës së Shqipërisë për uljen e rrezikut të përhapjes së armëve dhe keqpërdorimit të armëve të vogla dhe të lehta



**Ki guxim t'u thuash jo armëve!**





Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
Prezenca në Shqipëri



## PËRTEJ KRYETITUJVE

# MANUAL PËR GAZETARËT QË RAPORTOJNË PËR ÇËSHTJET E SIGURISË, ARMËT E VOGLA E TË LEHTA DHE DHUNËN ME BAZË GJINORE NË SHQIPËRI

Mars 2025



Co-funded by  
the European Union



RÉPUBLIQUE  
FRANÇAISE

*Liberté  
Égalité  
Fraternité*

*Ky manual u hartua nga Michelle Betz, konsulente ndërkombëtare, dhe u përshtat në kontekstin shqiptar nga Thanos Goga, konsulent kombëtar, të cilët u kontraktuan nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, si pjesë e projektit “Asistencë për autoritetet e Republikës së Shqipërisë për uljen e rrezikut të përhapjes së armëve dhe keqpërdorimit të armëve të vogla dhe të lehta (AVL)”, i cili zbatohet nga Prezenca e OSBE-së dhe financohet nga Bashkimi Evropian, Gjermania dhe Franca. Këndvështrimet dhe opinionet e shprehura në këtë dokument janë të autorëve dhe të pjesëmarrësve të këtij studimi dhe jo domosdoshmërisht reflektojnë ato të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, të Bashkimit Evropian, të Gjermanisë apo Francës.*

## Përmbajtja

|                                                                                                |    |
|------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Parathënie .....                                                                               | 7  |
| Akronime .....                                                                                 | 8  |
| Hyrje .....                                                                                    | 9  |
| Pse u hartua ky manual? .....                                                                  | 10 |
| Termet kyç .....                                                                               | 12 |
| Udhëzuesit kryesorë për raportimin e DhBGj-së dhe AVL-ve .....                                 | 14 |
| Etika në raportimin e DhBGj-së dhe AVL-të .....                                                | 14 |
| Përkufizimet kyçe .....                                                                        | 15 |
| Kapitulli 1 Raportimi për armët e vogla dhe të lehta (AVL) .....                               | 16 |
| 1.1 Çfarë janë Armët e Vogla dhe të Lehta? .....                                               | 16 |
| 1.2 Ndikimi global i AVL-ve .....                                                              | 18 |
| 1.3 Cikli i jetës dhe përhapja e AVL-ve .....                                                  | 20 |
| 1.4 Roli i medias në rritjen e ndërgjegjësimit për AVL-të .....                                | 24 |
| 1.5 Raportimi etik dhe praktikatat e mira .....                                                | 25 |
| 1.6 Armët e Vogla dhe të Lehta në Shqipëri .....                                               | 29 |
| Rast studimi: Raportimi për sjellje të pahijshme të policisë dhe AVL-të në Evropën Qendrore .. | 34 |
| Kapitulli 2 Dhuna me bazë gjinore (DhBGj) dhe ndërlidhja e saj me AVL-në .....                 | 35 |
| 2.1 Çfarë është DhBGj-ja? .....                                                                | 35 |
| 2.2 Dhuna me bazë gjinore në Shqipëri .....                                                    | 36 |
| 2.3 Roli i AVL-ve në përkeqësimin e DhBGj-së .....                                             | 37 |
| 2.4 Pse duhet raportimi për AVL-të dhe DhBGj-në? .....                                         | 39 |
| 2.5 DhBGj-ja dhe AVL-të në Shqipëri .....                                                      | 40 |
| 2.6 Raste studimi .....                                                                        | 43 |
| 2.6.1 Rast studimi: Mbulimi mediatik i dhunës me bazë gjinore në Ballkan .....                 | 43 |
| 2.6.2 Rast studimi: Mbulimi i dhunës në familje në Evropën Lindore .....                       | 44 |
| 2.6.3 Rast studimi: Kriza e dhunës me bazë gjinore në Afrikën e Jugut .....                    | 44 |
| 2.6.4 Rast studimi: Dhuna në familje gjatë pandemisë COVID-19 në Shtetet e Bashkuara ...       | 45 |
| Kapitulli 3 Raportimi për sigurinë, AVL-të dhe DhBGj-së: Praktikatat e mira .....              | 46 |
| 3.1 Gjetja dhe zhvillimi i ideve për histori .....                                             | 46 |
| 3.2 Gjetja e burimeve .....                                                                    | 47 |
| 3.3 Përdorimi i të dhënave .....                                                               | 49 |
| 3.4 Intervistimi .....                                                                         | 50 |
| 3.5 Raportimi i informuar për traumën .....                                                    | 52 |
| 3.6 Raportimi në bashkëpunim .....                                                             | 55 |
| 3.7 Raste studimi .....                                                                        | 57 |
| Shtojca I Punët e cituara .....                                                                | 60 |
| Shtojca II Burime shtesë .....                                                                 | 62 |
| Burime lokale .....                                                                            | 63 |
| Organizata .....                                                                               | 64 |
| Ekspertë .....                                                                                 | 64 |
| Faqe interneti dhe burime .....                                                                | 65 |



# Parathënie

Në botën e sotme, media ka rol thelbësor për ndërgjegjësimin e publikut dhe ndikon në reagimin politik ndaj çështjeve kritike, përfshirë Armët e Vogla dhe të Lehta (AVL) dhe Dhunën me Bazë Gjinore (DhBGj). Raportimi i saktë, i ndjeshëm dhe me përgjegjësi i këtyre çështjeve është thelbësor që publiku të kuptojë më mirë dhe të informohet për ndërhyrjet efektive dhe, çka është më kryesorja, për të sjellë ndryshim shoqëror domethënës.

Shqipëria ka bërë hapa të mëdhenj në adresimin e ndikimit të përhapjes së AVL-ve dhe DhBGj-së në komunitetet në mbarë vendin. Megjithatë, ka një sërë sfidash të cilat janë ende të pranishme dhe profesionistët e mediave janë të një rëndësie kritike për të hedhur dritë mbi çështje komplekse, duke treguar integritet dhe duke paraqitur informacion të thelluar. Duke njohur rolin tejet të rëndësishëm të gazetarëve, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka kënaqësinë të mbështesë hartimin e këtij manuali esencial, i cili synon posaçërisht ofrimin e njohurive dhe aftësive të nevojshme profesionistëve të mediave për të raportuar me saktësi dhe përgjegjshmëri për çështje të tilla delikate.

Ky manual u projektua për të rritur të kuptuarin e gazetarëve për sa u përket ndërlidhjeve komplekse midis AVL-ve dhe DhBGj-së, duke ofruar udhëzime praktike mbi raportimin etik, teknikat e rrëfimit dhe metodat për të shmangur përsëritjen e stereotipeve ose zgjatjes së dëmit në mënyrë të paqëllimshme. Ky manual thekson rëndësinë e të mbajturit në qendër të të mbijetuarve dhe të të drejtave të njeriut, gjatë gjithë mbulimit mediatik, duke siguruar dëgjimin e zërave të tyre, respektimin e të drejtave dhe ruajtjen e dinjitetit.

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri mbetet e përkushtuar në fuqizimin e peizazhit mediatik në Shqipëri nëpërmjet nismave që rrisin kapacitetet, partneritetet dhe standardet profesionale të gazetarëve. Besojmë vërtet se gazetaria e mirëinformuar dhe e përgjegjshme jo vetëm që informon publikun, por po ashtu shërben si katalizator i ndryshimit pozitiv në shoqëri.

Shpreh mirënjohjen time të thellë ndaj të gjithë gazetarëve, të cilët angazhohen çdo ditë në detyrën tejet të rëndësishme të mbulimit të këtyre sfidave. Përkushtimi juaj kontribuon ndjeshëm në ndërtimin e një shoqërie të informuar, të drejtë dhe empatike.

Nxis të gjithë profesionistët e medias që ta përdorin këtë manual si një burim praktik për punën e tyre si dhe të vijojnë të advokojnë për gazetari transparente, të ndjeshme dhe me ndikim në Shqipëri.

**Ambasadori Michel Tarran**

**Kryetar i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri**

## Akronime

---

|        |                                                                                                |
|--------|------------------------------------------------------------------------------------------------|
| PSH    | Policia e Shtetit                                                                              |
| BE     | Bashkimi Evropian                                                                              |
| DhBGj  | Dhuna me bazë gjinore                                                                          |
| KVSP   | Këshilli Vendor i Sigurisë Publike                                                             |
| MEICO  | Ndërmarrje Ushtarake Eksporti dhe Importi                                                      |
| MB     | Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë                                               |
| OSBE   | Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë                                                |
| AVL    | Armët e Vogla dhe të Lehta                                                                     |
| SEESAC | Zyra Qendrore për Evropën Lindore dhe Juglindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta |
| OKB    | Organizata e Kombeve të Bashkuara                                                              |
| UNDP   | Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara                                                   |
| UNODA  | Zyra e Kombeve të Bashkuara për Çështje Çarmatimi                                              |
| OBSH   | Organizata Botërore e Shëndetësisë                                                             |

# Hyrje

Ndikimi nga përhapja e pakontrolluar dhe posedimi i armëve të vogla dhe të lehta, municioneve dhe eksplozivëve mbetet një rrezik i madh për zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të Shqipërisë si dhe për sigurinë publike. AVL-të, municionet dhe eksplozivët e keqkontrolluar dhe të paligjshëm mbështesin elementët kriminalë si dhe krimin e organizuar, duke sjellë dhunë dhe pasiguri. Secili prej këtyre elementëve ndikon negativisht te masat që rrisin sigurinë dhe besimin në vend dhe në rajon.

Parandalimi, kontrolli dhe ndalimi i përhapjes së AVL-ve në përputhje me iniciativat dhe standardet ndërkombëtare, siç theksohet në Strategjinë Kombëtare të AVL-ve, përbëjnë prioritetet strategjike të qeverisë shqiptare.

Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë dhe Policia e Shtetit, si zbatuesit kryesorë të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit të AVL-ve, kanë përcaktuar një sërë fushash me prioritet ku mbështetja e OSBE-së ka qenë e mirëpritur. Një prej këtyre fushave me prioritet ka qenë rritja e kapaciteteve të autoriteteve, mediave, shoqërisë civile dhe Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike për të rritur ndërgjegjësimin mbi rreziqet nga keqpërdorimi dhe përhapja e AVL-ve.

Manuali për Gazetarët që raportojnë për çështje të sigurisë, AVL dhe dhunën me bazë gjinore është një udhërrëfyes gjithëpërfshirës i hartuar për gazetarët ndërsa ata përpiqen të mbulojnë sfidat unike të paraqitura nga këto çështje komplekse në Shqipëri. Ky manual u zhvillua duke u mbështetur te vlerësimi shterues i raportimit mediatik dhe te nevojat e gazetarëve për rritje kapacitetesh, duke shërbyer si kuadër teorik, por edhe si një paketë mjetesh për profesionistët e medias në platforma të ndryshme, përfshirë televizionin, radion, shtypin e shkruar dhe portalet online, që të mbulojnë në mënyrë efektive dhe me profesionalizëm këto çështje kritike dhe tepër të ndjeshme.

Ky manual është më shumë se një udhëzues. Ai është katalizator ndryshimi i hartuar për të qenë një dokument i gjallë i cili evoluon teksa peizazhi mediatik dhe çështjet që lidhen me AVL-të, sigurinë dhe DhBGj-në ndryshojnë. Duke ndjekur udhëzimet dhe praktikat e mira të radhitura këtu, gazetarët mund të kontribuojnë në zhvillimin e një diskursi më të sigurt dhe të mirëinformuar dhe të luajnë një rol të madh në uljen e rreziqeve që lidhen me armët e paligjshme të zjarrit si dhe dhunën me bazë gjinore në Shqipëri.

# Pse u hartua ky manual?

Media luan një rol të qenësishëm në rritjen e ndërgjegjësimit për rreziqet e AVL-ve. Nëpërmjet raportimit të saktë dhe të përgjegjshëm, gazetarët mund të informojnë publikun për rreziqet që vijnë nga armët e zjarrit të paligjshme dhe të advokojnë për masa kontrolli më të forta. Rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimi nëpërmjet medias kontribuojnë në uljen e ofertës, kërkesës dhe keqpërdorimit të armëve të zjarrit. Media mund të jetë efektive vetëm nëse ka informacion të përshtatshëm dhe të saktë për AVL-të dhe DhBGj-në. Raportimi mediatik mund të përmirësojë dialogun publik për çështjet e sigurisë mes komuniteteve lokale dhe strukturave të qeverisjes vendore.

Qëllimi kryesor i këtij manuali është rritja e standardeve profesionale të gazetarëve shqiptarë si dhe rritja e angazhimit të tyre në nisma që ndërgjegjësojnë publikun për rreziqet që vijnë nga përdorimi i paligjshëm i armëve të zjarrit. Duke iu ofruar gazetarëve njohuritë dhe mjetet e duhura, projekti i AVL-ve synon të rrisë mbulimin mediatik duke e bërë atë më informuar, më të përgjegjshëm dhe me më shumë ndikim për çështjet që lidhen me sigurinë, AVL-të dhe dhunën me bazë gjinore.

Gazetarët mund të jenë vendimmarrës tepër të rëndësishëm nëpër redaksitë e tyre kur bëhet fjalë për mënyrën se si do të mbulohen çështje dhe incidente specifike ku ka raste dhune ndaj grave. Duke ndërgjegjësuar kolegët e tyre, gazetarët mund të ndihmojnë në ndryshimin e agjendës së lajmeve.<sup>1</sup>

Në Shqipëri, ka shumë raste ku armëmbajtja e pakontrolluar ka çuar në dhunë me bazë gjinore, duke sjellë kështu pasiguri jo vetëm në familje dhe në komunitetet lokale, por edhe në tërë vendin. Duke qenë se dhuna me bazë gjinore ndaj vajzave dhe grave ka rrënja të thella në traditat dhe zakonet patriarkale, lind nevoja për përpjekje të forta për të ndikuar në uljen e AVL-ve dhe DhBGj-së.


Vlerësimi i nevojave tek “Monitorimi i medias dhe gazetarëve” ofron një analizë të plotë të situatës aktuale të raportimit mediatik të çështjeve të dhunës me bazë gjinore të shkaktuar nga armët e zjarrit si dhe ofron rekomandime për veprimtari të tjera zhvillimore për mediat.<sup>2</sup>

<sup>1</sup> Morgan & Simons (2017) në OSBE (2024). Vlerësimi i Nevojave të Gazetarëve, fq. 9.  
<sup>2</sup> OSCE (2024), fq. 10.

Sipas gjetjeve të studimit:

- Mes 36 historive/artikujve të shtypit të shkruar të përfshira në studim, vetëm njëri diskuton konkretisht dhunën me bazë gjinore si një fenomen të veçantë, duke e përfshirë atë brenda kontekstit më të gjerë të dhunës në familje.
- Mediat online shpesh përqendrohen te legjitimiteti i armëve të zjarrit të përdorura nga autorë të ngjarjeve të ndryshme që përfshijnë kanosje, plagosje ose vrasje vajzash/grash.
- Nga monitorimi i 96 artikujve, u zbulua se 55% prej tyre nuk përmbanin deklaratë nga institucione apo ekspertë të fushës.
- Monitorimi i 96 artikujve në total, 60 prej të cilëve nga mediat online dhe 36 nga shtypi i shkruar, tregoi se asnjë prej tyre nuk kishte funksion edukues për keqpërdorimin e armëve të zjarrit.
- Shpesh media publikon foto për të provokuar reagim emocional.
- Një numër i konsiderueshëm artikujsh të monitoruar jepte detaje për mënyrën se si rrodhi ngjarja kriminale, duke tejkaluar kështu funksionin informues të lajmeve mediatike. Po ashtu, theksi vihej tek disa detaje në kryetitull për të marrë klikime (media online) ose për të rritur shitjet e gazetave (në rastet e shtypit të shkruar).
- Gazetarët nga ana e tyre nuk jepnin sqarime të mjaftueshme për çështjet e AVL-ve dhe DhBGj-së si problem social që mbështetet tek pabarazia e forcës mes burrave dhe grave.

Figura 1 Analiza e mbulimit mediatik në Shqipëri



## TERMAT KYÇ

---

**Municion:** Shtetet pjesëmarrëse bien dakord se fushëveprimi për adresimin e rezervave të municioneve, eksplozivëve dhe pajisjeve shpërthyes konvencional në rastet e tepricës dhe/ose në pritje për t'u shkatërruar duhet të jetë sa më i gjerë që të jetë e mundur. Municioni i referohet municioneve konvencional të projektuar për t'u qëlluar, ose shpërthyer nga armë të vogla dhe të lehta ose artileri, përfshirë çdo lëndë plasëse ose lëndë djegëse.

Sipas dokumentit municioni konvencional krijohet me qëllim për t'u përdorur në lloje të ndryshme armësh (p.sh. armë të vogla dhe të lehta, mortaje, dhe artileri). Dokumenti vë në dukje rëndësinë e ruajtjes së sigurt të tyre si dhe mbajtjen e një inventarit efektiv për të kontrolluar dhe parandaluar aksidentet ose diversionin e paligjshëm.

**Inteligjencë artificiale (IA):** Aftësia e kompjuterit digjital ose robotit të kontrolluar nga kompjuteri për të kryer veprime që zakonisht lidhen me qenie inteligjente.

**Embargo armësh:** Ndalimi i tregtisë së AVL-ve në shtete ose grupe specifike, zakonisht i zbatuar nga organe ndërkombëtare si Organizata e Kombeve të Bashkuara për të parandaluar përshkallëzimin e konfliktit (UNODA).

**Qarkullim:** Numri i AVL-ve që është transferuar tashmë në një vend specifik dhe ka lëvizur nëpërmjet transaksioneve të paligjshme dhe të ligjshme, ose në tregun gri dhe atë të zi.

**Demobilizim dhe riintegrim (DDR):** Kuadri për çarmatimin e luftëtarëve, shpërbërjen e grupeve të armatosura dhe ndihmën e ofruar ish luftëtarëve për t'u riintegruar në jetën civile, e cila shpesh përfshinë kontrollin dhe menaxhimin e AVL-ve (UNODA).

**Difuzion:** Nënkupton se armët janë përhapur brenda dhe jashtë kufijve kombëtarë në nivel shtetëror dhe nënshtetëror. Kombinon të dyja konceptet e qarkullimit dhe të përhapjes së bashku me njëra tjetrën. Modelet e difuzionit tregojnë se tregtia e AVL-ve ndodh nëpërmjet mijërave transaksioneve të vogla në shoqëri në vend të ngarkesave të mëdha, të cilat janë tipike të sistemeve konvencionale të armatimeve.

**Çarmatim:** Procesi i uljes ose eliminimit të AVL-ve brenda shtetit ose zonës së konfliktit, shpesh është pjesë e përpjekjeve për të sjellë paqe dhe rimëkëmbje pas konfliktit (OSBE AVL).

**Eksplzivë:** Materiale ose pajisje të projektuara për të prodhuar sasi të mëdha energjie në një periudhë të shkurtër kohore. Kjo përfshin eksplozivët e fuqishëm të përdorur në municione, mina dhe pajisje të sajuara eksplozive.

Ky dokument analizon nevojën për ruajtjen e duhur, menaxhimin dhe asgjësimin e eksplozivëve për të parandaluar shpërthime aksidentale ose keqpërdorim të mundshëm të këtyre materialeve të rrezikshme, sidomos në zonat e konfliktit ose në rajone të paqëndrueshme.

**Armë zjarri:** Të gjitha llojet e armëve të zjarrit (pistoletë, pushkë, eksplozivë etj.)

**Dhunë me bazë gjinore ndaj grave (DhBGj):** Të gjitha format e dhunës së burrave ndaj grave, të kryera për shkak të gjinisë së viktimës, d.m.th. sepse ata janë gra.

**Trafik i paligjshëm:** Lëvizja dhe tregtia e paligjshme e AVL-ve, shpesh duke kontribuar në dhunë dhe krime në zonat e konfliktit dhe përtej tyre (UNODA).

**Armë të lehta:** Armë të projektuar për t'u përdorur nga një grup i vogël, përfshirë mitralozat e rëndë, granatahedhëse të montueshëm për pushkë automatike, sistemet e lëvizshme kundërtanke dhe kundërajror, raketahedhëse të lëvizshme kundërtanke dhe sistemet raketore; dhe mortaje të kalibrit nën 100 mm (OSBE AVL).

**Përhapje:** Përhapja dhe disponueshmëria e shpejt e AVL-ve, e cila mund të çojë në destabilizim të rajoneve, sidomos në shtete të dobëta ose të dështuara (Organizata Botërore e Doganave) (UNODA).

**Komision i AVL-ve:** Këshilli Kombëtar i AVL-ve është një organ këshillimor mes departamentesh përgjegjës për këshillimin e qeverisë në zhvillimin dhe zbatimin e politikave të kontrollit të AVL-ve. Komisione të tilla zakonisht përmbajnë përfaqësues nga departamente të ndryshme, përfshirë ato të mbrojtjes, sigurisë, punëve të brendshme, zbatimit të ligjit etj. Përgjegjësitë e tyre kryesore përfshijnë zhvillimin e strategjive dhe politikave, ofrimin e mbështetjes nëpërmjet këshillimit të aktorëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë, bashkërendimin dhe mbikëqyrjen e përpjekjeve për zbatim, zhvillimin e hulumtimeve dhe mbledhjen e të dhënave, rritjen e ndërgjegjësimit, advokimin për kontrollin e armëve dhe rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar.

**Armë të vogla:** Armët e zjarrit të krijuara për përdorim individual, përfshirë pistoletat, revolverët, pushkët, karabinat, gjysmëmitralozat, pushkët automatike dhe mitralozat e lehtë (UNODA) (OSBE AVL).

**DhGV:** Dhuna ndaj grave dhe vajzave

Për listën gjithëpërfshirëse të termave të lidhur me AVL-të mund të shikoni: <https://www.msag.es/index.php/about-msag/31-glossary-of-salw-ca-terms>

## Udhëzuesit kryesorë për raportimin e DhBGj-së dhe AVL-ve

Nëse keni për të lexuar vetëm një seksion të këtij manuali, lexoni këtë.

### Etika në raportimin e DhBGj-së dhe AVL-të

#### **Raportimi i informuar për traumën:**

- Kuptoni ndikimin psikologjik të dhunës tek të mbijetuarit. Shmangni ritraumatizimin e individëve duke përdorur gjuhë të kujdesshme dhe përgatitini kronikat me kujdes.
- Vendosni të mbijetuarit në qendër të raportimit, që ka si prioritet mirëqenien e tyre.

#### **Shmangni raportimet sensacionale:**

- Prezantoni faktet pa ekzagjerime ose imazhe provokuese që mund të turbullojnë perceptimin e publikut dhe të lartësojnë dhunën.
- Shmangiuni dhënies së detajeve sensacionale, sidomos në kryetituj dhe në pjesët vizuale, të cilat shërbejnë kryesisht për marrjen e klikimeve në vend të informimit të përgjegjshëm.

#### **Siguroni përfaqësim të balancuar:**

- Jepni kontekstin për të shmangur stereotipat e vazhdueshëm ose rrëfimet e njëanshme, sidomos ato të lidhura me autorët dhe të mbijetuarit.
- Vendoseni theksin te çështjet sistemike, të tilla si normat shoqërore dhe boshllëqet e politikave në vend, që të fokusoheni te rastet individuale.

#### **Jini të ndjeshëm për kulturën:**

- Kini parasysh normat kulturore dhe temat e ndjeshme aty ku traditat mund të ndikojnë diskursin rreth DhBGj-së dhe AVL-ve.
- Kërkoni të sfidoni stereotipat e dëmshëm ndërkohë që respektoni kontekstet lokale.

#### **Siguroni transparencë dhe llogaridhënie:**

- Bëni dallimin e qartë mes fakteve, opinioneve dhe advokacisë në raportim. Ruani transparencën e burimeve dhe shmangni konfliktin e interesit.

#### **Mbani mend rolin edukativ të medias:**

- Shërbeni si një platformë edukative për publikun për sa u përket rreziqeve nga përhapja e AVL-ve dhe ndikimin shoqëror të DhBGj-së, përfshirë rrënjët e saj në pabarazinë gjinore.
- Shmangni normalizimin e dhunës dhe përhapjen e frikës, duke u përqendruar te zgjidhjet si çarmatimi dhe sistemet që ofrojnë mbështetje të të mbijetuarve.

#### **Bashkëpunoni me ekspertë:**

- Punoni me ekspertë ligjorë, psikologjikë dhe politikë për të siguruar saktësi në përshkrimin e ligjeve, përgjigje ndaj traumës dhe ndërlidhje më të gjera të DhBGj-së dhe AVL-ve.

**Mbroni grupet e cënueshme dhe respektoni viktimat:**

- Ndërmerrni masa shtesë gjatë raportimit për fëmijët, të mbijetuarit e dhunës seksuale, ose grupet e tjera të marginalizuara, për të ruajtur privatësinë dhe dinjitetin.
- Ruani dinjitetin dhe privatësinë gjatë mbulimit të rasteve të ndjeshme. Shmangni gjuhën sensacionale, imazhet grafike dhe pyetjet që tejkalojnë kufijtë e raportimit.

**Mbroni burimet:**

- Siguroni konfidencialitetin e sinjalizuesve dhe të mbijetuarve nëpërmjet komunikimit të enkriptuar dhe anonim, aty ku është e nevojshme.
- Fitoni besimin e të mbijetuarve dhe të komuniteteve duke treguar ndjeshmëri dhe përkushtim ndaj gazetarisë etike.

**Pëlqimi i informuar:**

- Kërkoni gjithmonë për pëlqimin eksplisit të të mbijetuarve përpara se të ndani identitetet apo historitë e tyre.

**Vendoseni raportimin në kontekst:**

- Vendosini raportimet brenda konteksteve shoqërore, kulturore, ligjore dhe shmangni përhapjen e stereotipave ose paragjytimeve.

**Saktësia dhe qartësia:**

- Përdorni terminologji precize dhe shmangni emërtimin e gabuar të armëve ose thjeshtëzimin e tepërt të çështjeve komplekse.

**Përkufizimet kyçe**

**Dhunë me bazë gjinore (DhBGj):** Veprimet e dëmshme të kryera duke u bazuar në gjininë, përfshirë abuzimin fizik, seksual, psikologjik, që i ka rrënjët në pabarazinë e forcës.

**Armë të vogla dhe të lehta (AVL):** Armë të lëvizshme për përdorim individual ose nga një grup i vogël, përfshirë pistoletat, pushkët, mitralozat dhe granatahedhëset.

**Trafik i paligjshëm:** Përgjithësisht kuptohet si tregtia, transferimi ose shpërndarja e paligjshme e AVL-ve në kundërshtim me ligjet kombëtare, marrëveshjet ndërkombëtare ose rregulloret për kontrollin e armëve. Ky trafik zakonisht përfshin lëvizjen dhe armëmbajtjen e paautorizuar të AVL-ve përtej kufijve ose brenda shtetit.

**Çarmatim:** Përpjekjet për të ulur ose eliminuar AVL-të në një shtet ose rajon për të rritur sigurinë.

**Përdorim i armëve në kanosjet me bazë gjinore:** Përdorimi i armëve të zjarrit për të kanosur dhe kontrolluar viktimat, duke i bërë ato të heshtin e zgjatur kështu abuzimin.

# Kapitulli 1 Raportimi për Armët e Vogla dhe të Lehta (AVL)

Njohuritë mbi AVL-të u mundësojnë gazetarëve të raportojnë në mënyrë të përgjegjshme për flukset ndërkombëtare të armëve, trafikun e paligjshëm dhe politikat që synojnë rregullimin e tyre. Të kuptuarit e llojeve, burimeve dhe rrugëve të armëve mund të ndihmojë gazetarët të ekspozojnë se si dhuna lokale lidhet me rrjetet globale, duke vënë në dukje ndërlidhjet ekonomike, politike dhe humanitare. Njohuritë e thelluara për AVL-të u mundësojnë gazetarëve të ekzaminojnë në mënyrë kritike veprimet qeveritare dhe ushtarake, të raportojnë për përpjekjet për çarmatim dhe të rrisin ndërgjegjësimin për ndikim shoqëror të këtyre armëve në komunitetet e përfshira, duke rritur informimin në diskursin publik dhe zhvillimin e politikave.

## 1.1 Çfarë janë Armët e Vogla dhe të Lehta?

Ka një sërë përkufizimesh për **Armët e Vogla dhe të Lehta (AVL)**, pasi termi përdoret në një sërë kontekstesh nga organizata të ndryshme, por përgjithësisht i referohet një kategorie të gjerë armësh zjarri. Përkufizimet që përdoren më shpesh vijnë nga:

1. **Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB):** OKB-ja ka një përkufizim të gjerë për AVL-të, duke përfshirë armë të tilla si pushkët, pistoletat, mitralozat dhe raketahedhëset, të cilat janë lehtësisht të lëvizshme dhe të përdorshme nga një ushtar i vetëm apo grupe të vogla.
2. **Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh):** OBSh-ja përqendrohet në ndikimin që këto armë kanë te shëndeti publik, duke i përkufizuar AVL-të kryesisht si armë zjarri dhe armë të lehta, të cilat përdoren shpesh në kontekste civile si dhe ushtarake.
3. **Bashkimi Evropian (BE):** Bashkimi Evropian ka një përkufizim të ngjashëm për AVL-të, por përqendrohet më shumë te nevoja për të rregulluar armë të tilla për të parandaluar trafikun e paligjshëm, sidomos në zonat e konfliktit.
4. **Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE):** OSBE-ja i përkufizon AVL-të si armë të projektuara për përdorim individual, përfshirë armët e vogla: pushkët, revolverët, pistoletat dhe çiftet (shotgun), të cilat synohen të përdoren nga një person i vetëm, dhe armë të lehta: armët më të rënda të cilat mund të operohen nga një ekip i vogël, të tilla si mitraloza, granatahedhëse, sisteme të lëvizshme raketore.
5. **Përkufizimet kombëtare:** Disa shtete kanë përkufizimet e tyre, mbështetur në nevojat specifike të politikave të kontrollit të armëve.

Në thelb, edhe pse përkufizimet mund të ndryshojnë pak në varësi të organizatës, shumica prej tyre i përafrohet klasifikimit të përgjithshëm të armëve të vogla (armë të projektuara për përdorim individual, si pistoletat dhe pushkët) dhe armëve të lehta (më të rënda, por mbeten armë të lëvizshme, si mitraloza dhe granatahedhëse). Pra, nuk ka një përkufizim të pranuar në mënyrë universale, por ka një sërë interpretimesh në varësi të kontekstit.

#### **PËRKUFIZIMET KYÇE:**

##### **Armët e vogla dhe të lehta (AVL), siç përkufizohen në Dokumentin e OSBE-së për AVL-të**

- Armët e Vogla janë armë zjarri të projektuara për t'u përdorur nga një person. Shembujt përfshijnë:
  - Revolverë dhe pistoleta gjysmë automatike
  - Pushkë dhe karabina
  - Gjysmëmitraloza
  - Çifte (shotgun)
- Armët e Lehta janë armë më të rënda se armët e vogla, por mbeten të lëvizshme dhe mund të operohen nga një ekip i vogël. Shembujt përfshijnë:
  - Mitralozat e rëndë
  - Granatahedhëse të montuara për pushkë automatike
  - Armë të lëvizshme kundërajrore
  - Armë të lëvizshme kundërtanke
  - Armë të lëvizshme kundërtanke dhe kundër sistemeve ajrore (OSBE AVL).

Këto armë kanë rëndësi të madhe, ngaqë janë gjerësisht të aksesueshme, përdoren, fshihen dhe transportohen lehtë duke u kthyer në mjetet kryesore të dhunës së armatosur të lidhur me terrorizmin, krimin e organizuar, ekstremizmin e dhunshëm dhe paqëndrueshmërinë shoqërore. Po ashtu përdoren në shumë konflikte moderne, si në betejat konvencionale, ashtu dhe në aktivitetet kriminale. Është thelbësore që gazetarët t'i kuptojnë AVL-të, meqenëse këto armë luajnë një rol të madh në përshkallëzimin e dhunës dhe paqëndrueshmërisë globale, rajonale dhe kombëtare dhe, duke qenë se janë shpesh armët e përdorura në një larmi kontekstesh sigurie, përfshirë luftëra civile, kryengritje, veprime kriminale, akte terrorizmi dhe dhunë me bazë gjinore.

Disponueshmëria e gjerë dhe lehtësia e përhapjes së AVL-ve i bën ato një faktor të rëndësishëm në dhunën globale dhe në abuzimin e të drejtave të njeriut. Gazetarët që mbulojnë zonat e konfliktit, krimet apo çështjet e sigurisë duhet të njihen me terminologjinë e AVL-ve (shikoni termat kyç te faqet 7-8) dhe karakteristikat për raportim të saktë të rolit të tyre në rritjen e paqëndrueshmërisë dhe kontributin e tyre për dëmtimin e qytetarëve në shkallë të lartë. Të kuptuarit e këtyre termave është një ndihmë për gazetarët teksa përgatisin raportimet e tyre në mënyrë më të informuar dhe precize, çka është thelbësore për të transmetuar saktësisht rolin e AVL-ve në sfidat e sigurisë botërore.

Aktorët kombëtarë dhe rajonalë janë gjithnjë e më shumë të përqendruar tek edukimi i gazetarëve në këtë fushë, pasi raportimi i tyre është bërë një burim i rëndësishëm i informacionit të hapur që mund të mbështesë proceset vendimmarrëse. Një shembull i këtij bashkëpunimi është Lajme – Kontrolli i AVL-ve - Platforma e Monitorimit të Dhunës së Armatosur: 2023 Vështrim i Incidenteve me Armë Zjarri- SEESAC si dhe Instituti Flamand i Paqes (Flemish Peace Institute).

Njohja me natyrën e shumanshme të AVL-ve dhe të kuptuarit pse përhapja e tyre është një kërcënim dhe rrezik kaq i gjerë, u mundëson reporterëve të gjurmojnë dhe hetojnë fluksin e armëve, duke hedhur dritë mbi çështje të tilla si: kontrabandimi i armëve, rrjetet e trafikimit, sfidat e çarmatimit dhe përpjekjet për kontroll.

### Njohja e Armëve të Vogla dhe të Lehta

Figura 2 - Armët e vogla dhe të lehta<sup>3</sup>



## 1.2 Ndikimi global i AVL-ve

AVL-të kanë një ndikim të madh dhe të gjerë në sigurinë globale, duke kontribuar në përhapjen e dhunës, paqëndrueshmërisë dhe vuajtjes njerëzore. Këto armë janë përgjegjëse për shumicën e njerëzve të vdekur në konflikte të armatosura dhe përdoren shpesh në veprimtari kriminale dhe dhunë ndërpersonale. Të kuptuarit e prevalencës së tyre si dhe sfidat që ato paraqesin është thelbësore për gazetarët që raportojnë konflikte, krime dhe çështje që lidhen me të drejtat e njeriut.

### Prevalenca e armëve të paligjshme të zjarrit

Sipas Sondazhit të Armëve të Vogla (Small Arms Survey), përlogaritet se 1 miliard armë të vogla qarkullojnë anembanë botës dhe një numër i konsiderueshëm i tyre ndodhet në duart e civilëve. Besohet se rreth 85% e këtyre armëve të zjarrit është në pronësi të civilëve, ndërsa përqindja tjetër ndodhet në dispozicion të ushtarakëve dhe agjencive ligjzbatuese. Megjithatë, një numër i lartë armësh qarkullojnë në mënyrë të paligjshme duke rritur dhunën dhe paqëndrueshmërinë në rajone të ndryshme nëpër botë. Tregtia e paligjshme e AVL-ve vlerësohet diku te 1-2 miliard dollarë në vit dhe shpesh lulëzon në rajonet e prekura nga qeverisja e dobët, korrupsioni dhe konflikti.

Armët e paligjshme të zjarrit trafikohen përtej kufijve dhe shpesh bien në duart e organizatave kriminale, grupeve kryengritëse dhe grupeve terroriste. Këto armë shpesh përdoren në raste dhune mes bandash, krimi të organizuar dhe veprimesh terroriste, duke përhapur pasigurinë në vendet e zhvilluara dhe në

3 <https://www.osce.org/files/f/documents/5/4/359006.pdf>

vendet në zhvillim. Në rajone të tilla si Ballkani Perëndimor dhe Lindja e Mesme si dhe pjesë të Afrikës, fluksi i AVL-ve të paligjshme zgjat ciklin e dhunës dhe minon përpjekjet për stabilizim të shoqërive postkonfliktuale.

Ndikimi i armëve të paligjshme të zjarrit zgjerohet përtej shqetësimeve për siguri publike, duke kontribuar në paqëndrueshmëri më të gjerë shoqërore. Keqpërdorimi i AVL-ve është i lidhur me mosmarrëveshje në familje, akte kriminale dhe trafik ndërkufitar, shpesh duke zgjatuar ciklin e dhunës. Ndonëse Shqipëria ka përparuar falë iniciativave që synojnë uljen e tregtisë së paligjshme të armëve dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik, nevojitet bashkëpunim ndërkufitar më i lartë si dhe investime në kapacitetet e zbatimit të ligjit për të adresuar sfidat e përhapjes së armëve të paligjshme të zjarrit.

#### *AVL-të dhe dhuna në komunitet*

Prania e AVL-ve të paligjshme në komunitetet rrit ndjeshëm riskun e dhunës, sidomos në zonat të cilat janë duke përjetuar paqëndrueshmëri. Disponueshmëria e armëve të zjarrit në konfliktet ndërpersonale, në veprimtaritë kriminale dhe në dhunën në familje rrit vdekshmërinë. Në zonat e konfliktit, grupet e armatosura përdorin AVL-të për të terrorizuar popullsitë civile, duke çuar në zhvendosje masive të popullsisë, abuzime në të drejtat e njeriut dhe zgjatje të konflikteve.

Edhe në ambientet jo konfliktuale, përhapja e AVL-ve kontribuon në nivele të larta dhune. Në Amerikën Latine, për shembull, ku armëmbajtja është në nivele mjaft të larta, përdorimi i AVL-ve në raste dhune mes bandash dhe krimi të organizuar ka çuar në përqindjet më të larta të vrasjeve në të gjithë botën.<sup>4</sup> Po ashtu, në Shtetet e Bashkuara, disponueshmëria e gjerë e armëve të zjarrit, përfshirë armët e paligjshme, ka çuar në raste shumë të larta vdekjesh të lidhura me armët, përfshirë vetëvrasje, vrasje dhe tentativa për vrasje në masë.

Në Shqipëri, veprimtaritë e paligjshme që përmbajnë armë zjarri janë zakonisht armëmbajtja pa leje, shitja dhe prodhimi i armëve në mënyrë të paligjshme, dhuna në familje, incidente kriminale dhe mosmarrëveshje publike. Keqpërdorimi i tyre është veçanërisht vdekjeprurës në rastet e dhunës në familje, me të dhënat nga Sondazhi i AVL-ve në 2015 – 2016 që tregojnë se armët e zjarrit u përdorën në një të tretën e vrasjeve të kryera nga anëtarët e familjes dhe në shumicën e rasteve viktimat ishin gra.

Ndonëse burrat përbëjnë pjesën dërrmuese të viktimave të shkaktuara nga armët e zjarrit (86.4%), gratë ndikohen në mënyrë joproporcionale në rastet e dhunës në familje, me përqindje më të lartë të fataliteteve (edhe pse gratë ishin viktimë në 13.6% të incidenteve).<sup>5</sup>

Ndikimi gjinor nga keqpërdorimi i armëve të zjarrit vë në dukje rolin e rëndësishëm që ato luajnë në zgjatjen e dhunës në sferën publike si dhe atë private.

#### *Roli i AVL-ve në zgjatjen e pasigurisë*

AVL-të rrisin pasigurinë jo vetëm duke rritur vdekshmërinë nga dhuna, por edhe duke minuar autoritetin shtetëror dhe mundësinë e zbatimit të ligjit. Në rajonet ku grupet e armatosura kanë fuqi të konsiderueshme zjarri, qeveritë luftojnë për të ruajtur kontrollin, ndërsa agjencitë e zbatimit të ligjit shpesh e gjejnë veten të paarmatosur. Kjo dobëson institucionet shtetërore, nxit pandëshkueshmërinë dhe lejon organizatat kriminale dhe kryengritësit të veprojnë lirshëm.

Për më tepër, tregtia e paligjshme e AVL-ve shpesh lidhet me forma të tjera të krimit ndërkombëtar, përfshirë trafikun e drogës, trafikimin e qenieve njerëzore dhe terrorizmin. Rrjetet kriminale përdorin

4 SEESAC (2019a). Sondazhi i Armëve të Vogla dhe të Lehta (AVL): Shqipëria 2012 – 2016. U aksesua më 25 nëntor, 2024. [https://www.seesac.org/f/docs/SALW-Surveys/web\\_Albania-SALW-Survey\\_ENG.pdf](https://www.seesac.org/f/docs/SALW-Surveys/web_Albania-SALW-Survey_ENG.pdf)

5 Shikoni: [https://www.seesac.org/f/docs/Gender-and-SALW/Gender-And-Small Arms\\_ALBANIA\\_ENG\\_WEB\\_1.pdf](https://www.seesac.org/f/docs/Gender-and-SALW/Gender-And-Small Arms_ALBANIA_ENG_WEB_1.pdf)

armë zjarri për të mbrojtur operacionet e tyre, për të frikësuar komunitetet dhe për të luftuar grupet kundërshtare. Dhuna që vjen si rezultat destabilizon rajone të tëra, pengon investimet dhe përpjekjet për zhvillim.

Në Shqipëri, prevalenca e AVL-ve paraqet sfida të rëndësishme për sigurinë dhe qeverisjen publike. Mbajtja dhe keqpërdorimi i paligjshëm i armëve të zjarrit lidhet me krimin e organizuar dhe minon mundësinë e zbatimit të ligjit për të ruajtur rendin. Grupet kriminale shpesh përdorin armë të paligjshme për t'i rezistuar zbatimit të ligjit, për të frikësuar komunitetet dhe për të zgjatur pandëshkueshmërinë. Këto çështje janë veçanërisht aktive në zonat rurale, ku prania e shtetit dhe zbatimi i rregullit është më i dobët, duke përkeqësuar rreziqet për sigurinë publike.<sup>6</sup>

Armët e zjarrit luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm të dhuna në familje dhe mosmarrëveshjet familjare, me një shkallë vdekshmërie jo proporcionale në raste të tilla. Raportet tregojnë se zakonisht ka përdorim armësh zjarri në dhunën me bazë gjinore, duke nënvizuar koston njerëzore nga përhapja e AVL-ve. Ndërkohë që Shqipëria ka zbatuar reforma legislative dhe ka marrë pjesë në përpjekjet rajonale për çarmatim, të tilla si ato të udhëhequra nga SEESAC-u dhe të mbështetura nga Udhërrëfyesi i AVL-ve në Ballkanin Perëndimor<sup>7</sup>, boshllëqet në zbatim dhe vijueshmëria e armëve të zjarrit të paregjistruara mbeten pengesa të rëndësishme. Adresimi i këtyre çështjeve kërkon bashkëpunim të qëndrueshëm rajonal, kapacitete të zgjeruara të zbatimit të ligjit dhe nisma të forta për ndërgjegjësim publik.

Përpjekjet për të adresuar këto sfida në Shqipëri përfshijnë miratimin e një Strategjie Kombëtare për Kontrollin e Armëve të Vogla, Armëve të Lehta dhe Eksplozivëve për 2019 – 2024.<sup>8</sup> Kjo strategji është në përputhje me kornizat ndërkombëtare si Udhërrëfyesi i AVL-ve në Ballkanin Perëndimor dhe synon modernizimin e aftësitë të zbatimit të ligjit, përmirësimin e kuadrit ligjor dhe integrimin e konsideratave gjinore në kontrollin e AVL-ve. Për më tepër, projektet e mbështetura nga organizata si UNDP-ja dhe OSBE-ja fokusohen në rritjen e kapaciteteve të zbatimit të ligjit, përmirësimin e menaxhimit të provave dhe rritjen e ndërgjegjësimin të publikut për rreziqet nga përhapja e armëve të zjarrit.

### 1.3 Cikli i jetës dhe përhapja e AVL-ve

AVL-të mund të keqpërdoren në mënyra të ndryshme në mjedise ku shteti nuk është në gjendje të kontrollojë plotësisht aksesin dhe posedimin e paligjshëm të armëve. Ndryshe nga armët e rënda, që qarkullojnë si në tregjet ushtarake ashtu edhe në ato civile, disponueshmëria e armëve të vogla dhe të lehta priret të rritet në rastet kur ka transformime politike, ekonomike dhe sociale brenda shteteve.

Ndonëse nuk është gjithmonë e mundur të përcaktohet me saktësi mënyra se si AVL-të dhe municionet e paligjshme e gjejnë rrugën e tyre nga një vend në një vend tjetër dhe përfundimisht në duart e civilëve, ka disa mënyra të mundshme se si kjo mund të ndodhë:

6 UNDP Albania. Project Support Albania's Law Enforcement Authorities to Strengthen Firearms Criminality Evidence Management and Investigation Capacities. United Nations Development Programme (UNDP). Accessed November 24, 2024. <https://www.undp.org/albania/projects/support-albanias-law-enforcement-authorities-strengthen-firearms-criminality-evidence-management-and-investigation-capacities>.

7 SEESAC. Roadmap for a Sustainable Solution to the Illegal Possession, Misuse and Trafficking of Small Arms and Light Weapons (SALW) and Their Ammunition in the Western Balkans by 2024. South Eastern and Eastern Europe Clearinghouse for the Control of Small Arms and Light Weapons. September 27, 2019. Accessed November 24, 2024. <[www.seesac.org/f/docs/publications-salw-control-roadmap/Regional-Roadmap-for-a-sustainable-solution-to-the.pdf](http://www.seesac.org/f/docs/publications-salw-control-roadmap/Regional-Roadmap-for-a-sustainable-solution-to-the.pdf)>

8 Small Arms and Light Weapons, Their Ammunition and Explosives Control Strategy, 2019-2024, Albania. South Eastern and Eastern Europe Clearinghouse for the Control of Small Arms and Light Weapons. 2019. Accessed November 24, 2024. [https://www.seesac.org/f/docs/Albania-1/ENG\\_Albanian\\_Strategy\\_on\\_Firearms\\_Control-24-06-2019.pdf](https://www.seesac.org/f/docs/Albania-1/ENG_Albanian_Strategy_on_Firearms_Control-24-06-2019.pdf).

- Armët e kapura nga armiqtë gjatë dyluftimeve
- Ushtarët që largohen nga grupet e armatosura
- Rezervat paqeruajtëse të humbura, të vjedhura ose të kapura (nga trupa ndërkombëtare paqeruajtës)
- Armë të furnizuara nga forcat e armatosura
- Blerja nëpërmjet tregut të hapur
- Furnizimi nga rezervat shtetërore të vendeve fqinje
- Trashëgimia nga familja dhe të afërmit ose miqtë

### Statistika kyçe

Këtu janë disa statistika kyçe të lidhura me armët e vogla dhe të lehta (AVL):

**Qarkullimi global:** Vlerësohet se ka më shumë se 1 miliard armë të vogla në qarkullim anembanë botës dhe shumica prej tyre, rreth 85%, është në duart e civilëve, rreth 13% mbahet nga forcat e armatosura qeveritare dhe rreth 2% nga agjencitë ligjzbatuese (shikoni [Organizata Botërore e Doganave](#)).

**Tregtia e paligjshme:** Tregtia e paligjshme e AVL-ve vlerësohet në rreth 1-2 miliardë dollarë çdo vit. Kjo tregti ka kontribut të konsiderueshëm në dhunë dhe konflikt, sidomos në rajonet me qeverisje të dobët ([UNODA](#)).

**Armëmbajtja civile:** Armëmbajtja civile e AVL-ve është më e lartë në Shtetet e Bashkuara, të cilat përbëjnë thuhetse 40% të armëmbajtjes civile në mbarë botën. Kjo e dhënë ilustron rolin e rëndësishëm të armëmbajtjes civile në shpërndarjen globale të armëve të vogla ([UNODA](#)).

**Vdekje dhe plagosje:** AVL-të janë përgjegjëse për një përqindje të konsiderueshme vdekjesh të shkaktuara në konflikte. Përlllogaritet se 500,000 vdekje në vit lidhen me armët e zjarrit, qoftë në zonat e armatosura, por edhe nga aktivitetet kriminale ([Organizata Botërore e Doganave](#)) ([UNODA](#)).

**Konfliktet e armatosura:** Në konfliktet e armatosura moderne, AVL-të janë armët e preferuara të autorëve, duke u përdorur në 95% të konflikteve të dhunshme. Preferohen për shkak të lëvizshmërisë, lehtësisë për t'u përdorur dhe disponueshmërisë ([UNODA](#)).

Legjislacioni ndërkombëtar për industrinë e armëve është më pak i detyrueshëm dhe i zbatueshëm krahasuar me industrinë e bananes apo sojës, duke bërë ekspertët të mendojnë se ky sektor përbën të paktën 40% të korrupsionit të njohur global.

90% e furnizimit global të armëve mundësohet nga vetëm 10 shtete. Në vitet e fundit, thuhetse 40% e furnizimit global të dokumentuar vjen nga SHBA-të. Thuhetse gjysma e eksporteve të armëve nga SHBA-të shkojnë në Lindjen e Mesme, sidomos në Arabinë Saudite, importuesin më të madh të armëve në botë.

### *Tregtia e ligjshme apo e paligjshme e AVL-ve*

Është thelbësore që gazetarët të kuptojnë dallimin midis tregtisë së ligjshme dhe të paligjshme të AVL-ve, pasi këto dy tregje shpesh mbivendosen duke krijuar sfida për sa i përket raportimit dhe rregullimit.

**Tregtia e ligjshme e AVL-ve** i referohet prodhimit, shitjes dhe transferimit të armëve mes shteteve, organizatave dhe individëve në përputhje me ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare. Këtu përfshihet shitja e armëve të aprovuara nga qeveritë për qëllime legjitime mbrojtjeje ose ndaj subjekteve private të autorizuar. Shqipëria, për shembull, është e angazhuar në eksportin e ligjshëm të armëve nga një ndërmarrje shtetërore, MEICO (Military Export Import Company) – (Ndërmarrje Ushtarake Eksporti dhe Importi). E themeluar më 1991-in, MEICO vepron nën drejtimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe menaxhon importin dhe eksportin e pajisjeve ushtarake. Për shembull, në 2004-ën, Shqipëria eksportoi në mënyrë të ligjshme 10 milionë fishekë në Irak, 10 tonë TNT drejt Bullgarisë në shkëmbim të eksplozivëve ushtarakë dhe 200 sende-trofe drejt Gjermanisë, në përputhje me rregulloret kombëtare dhe ndërkombëtare.<sup>9</sup>

**Tregtia e paligjshme e AVL-ve**, nga ana tjetër, përfshin prodhimin, shitjen, transportimin, posedimin e paligjshëm dhe përdorimin e paautorizuar të AVL-ve, shpesh duke kontribuar në dhunë ndërpersonale, konflikt të armatosur, terrorizëm, krim të organizuar dhe shkelje të të drejtave të njeriut.<sup>10</sup>

Në Shqipëri, në dhjetor të 2019-ës, autoritete nga Shqipëria dhe Kosova, të mbështetur nga Eurojust-i dhe Europol-i, shpërbënë një rrjet trafikimi armësh që vepronte në këto dy shtete. Të dyshuarit ishin të përfshirë në furnizimin, transportimin dhe shitjen e paautorizuar të armëve dhe eksploziveve, duke krijuar kështu rrugë komplekse kontrabandimi drejt Bashkimit Evropian. Ky operacion çoi në arrestimin e 14 individëve, duke theksuar kështu sfidat e shtruara nga trafiku i paligjshëm i armëve në rajon.<sup>11</sup>

Siç u sugjerua edhe më lart, dallimi midis tregtisë së ligjshme dhe të paligjshme mund të jetë i paqartë për disa arsye. Armë të prodhuara në mënyrë të ligjshme shpesh hynë në treg në mënyrë të paligjshme nëpërmjet korrupsionit, vjedhjes dhe diversionit, kur armë për qëllime ushtarake dhe policore vidhen ose rishiten në mënyrë të paligjshme. Po ashtu, disa shtete mund të angazhohen në marrëveshje të fshehta armësh, duke e bërë të paqartë ligjshmërinë e transaksioneve. Rregulloret e dobëta, kontrollet e pamjaftueshme kufitare dhe mbajtja e dobët e të dhënave e përkeqësojnë më tej problemin, duke e bërë gjurmimin e fluksit të armëve tejet të vështirë. Është shumë e rëndësishme që gazetarët të kuptojnë hapësirën gri gjatë investigimeve për trafikim të armëve dhe raportimeve për pasojat që vijnë nga rregulloret e dobëta për fluksin e armëve që kontribuojnë në dhunë dhe paqëndrueshmëri.

**Këshillë:** Për të gjetur më shumë informacion për hetimin e trafikut të armëve, shikoni:  
<https://gijn.org/stories/investigating-arms-trafficking/>

**Armëmbajtje e paligjshme:** Armët nga trazirat e 1997-ës në Shqipëri mbeten në qarkullim, duke krijuar bazën e një tregu të kufizuar kriminal për AVL-të dhe pjesë të çmontuara të armëve. Shumë prej këtyre AVL-ve janë të destinuara për tregje të tjera evropiane, por disa duket se shiten në tregjet e brendshme.<sup>12</sup>

9 Holtom et al., 2005, p. 81.

10 Shikoni: World Customs Organization and OSCE SALW.

11 Shikoni: <https://www.eurojust.europa.eu/news/arms-trafficking-group-uncovered-albania-and-kosovo>

12 OC Index. *Global Organized Crime Index*, 2023. Accessed November 24, 2024. <https://ocindex.net/2023/country/albania>

Tabela 1 - Numrat e përlogaritur të armëve të zjarrit të regjistruara dhe të paregjistruara <sup>13</sup>

| Shteti    | Armë zjarri të regjistruara |         | Armë zjarri të paregjistruara |         | Total   |         |
|-----------|-----------------------------|---------|-------------------------------|---------|---------|---------|
|           | I ulët                      | I lartë | I ulët                        | I lartë | I ulët  | I lartë |
| Shqipëria | 70,000                      | 70,000  | 200,000                       | 210,000 | 270,000 | 280,000 |

Shënim: Vlerat janë të rrumbullakosura në mijëshen më të afërt.

Tabela 2 – Vlerësimet e posedimit të armëve të zjarrit nëpër familje në Shqipëri <sup>14</sup>

| Shteti    | Numri total i familjeve në popullsi | Direkt (Të vetëraportuar) |                             | Indirekte (opinion për numrin e familjeve që posedojnë armë zjarri në një zonë) |                            | Mesatarja |               |
|-----------|-------------------------------------|---------------------------|-----------------------------|---------------------------------------------------------------------------------|----------------------------|-----------|---------------|
|           |                                     | % e familjeve             | Numri i ulët i përlogaritur | % e familjeve                                                                   | Numri i mesatares së lartë | Mesatarja | Numri mesatar |
| Shqipëria | 722,600                             | 6.5                       | 46,969                      | 17.2                                                                            | 124,287                    | 11.9      | 85.628        |

**Tregtia e paligjshme:** Mes 1997-ës dhe 2002-it, vlerësohet se 100,000 deri në 150,000 AVL u trafikuan jashtë Shqipërisë.<sup>15</sup> Këto të dhëna janë cituar shpesh nga burime të tilla si UNDP-ja dhe raporte qeveritare të asaj periudhe, ndërsa disa vlerësime sugjerojnë se deri në 200,000 AVL u kontrabanduan në Kosovë, Maqedoninë e Veriut dhe destinacione të tjera. Megjithatë, ekspertët kanë theksuar mungesën e një analize të detajuar për të paraqitur të dhëna precize për trendet aktuale të trafikimit.

**Metodat e trafikimit të armëve të zjarrit:** Trafikuesit e armëve të zjarrit mendohet se i fshehin armët në vetura, autobusë, kamionë, makina ose i mbajnë ato në trupat e tyre, duke i kaluar kështu në mënyrë të paligjshme përtej kufirit. Armët e zjarrit të trafikuar zakonisht mbahen në numër të vogël, një-dy armë çdo herë. Për t'i fshehur armët e zjarrit, ato shpesh çmontohen në përbërësit bazë. Shumica e trafikantëve janë burra 16-45 vjeç.<sup>16</sup>

**Dorëzimi vullnetar i armëve:** Pas plaçkitjes masive të depove shtetërore më 1997-ën, Shqipëria zbatoi një sërë programesh amnistie të armëve të paligjshme dhe pajisjeve ushtarake. Iniciativat kyç përfshijnë amnistinë e parë (1998 – 2002) dhe të dytë (2003 – 2005), të dyja synonin rikuperimin e armëve shtetërore nëpërmjet dorëzimit vullnetar. Përpjekjet u udhëhoqën nga Policia e Shtetit.

13 Holtom et al. 2005, pp. 45–48; SEESAC, 2006a, p. 11 as quoted in Carapic, J., 2014, p. 5. Handgun Ownership and Armed Violence in the Western Balkans. Small Arms Survey. <http://www.jstor.org/stable/resrep10623> See also: [https://www.google.com/url?sa=t&rct=j&q=&esrc=s&source=web&cd=&cad=rja&uact=8&ved=2ahUKEwiFt\\_f5zJuMAxWdJzQI-HU5rPCIQFnoECBkQAQ&url=https%3A%2F%2Fwww.saferworld-global.org%2Fdownloadfile.php%3Ffilepath%3Ddownloads%2Fpubdocs%2FAlbania%2520ENG%2520%2520CH3.pdf&usq=AOvVaw3NkOTEFotP320IPfyTgbkF&opi=89978449](https://www.google.com/url?sa=t&rct=j&q=&esrc=s&source=web&cd=&cad=rja&uact=8&ved=2ahUKEwiFt_f5zJuMAxWdJzQI-HU5rPCIQFnoECBkQAQ&url=https%3A%2F%2Fwww.saferworld-global.org%2Fdownloadfile.php%3Ffilepath%3Ddownloads%2Fpubdocs%2FAlbania%2520ENG%2520%2520CH3.pdf&usq=AOvVaw3NkOTEFotP320IPfyTgbkF&opi=89978449)

14 Carapic, J., 2014, *Handgun Ownership and Armed Violence in the Western Balkans*. Small Arms Survey, p.8. <http://www.jstor.org/stable/resrep10623>

15 Holtom et al., 2005, p. 39.

16 SALW and Explosives Control Strategy 2019-2024 and its Action Plan 2019-2021.

Tabela 3 – Armët e mbledhura nga dy amnistitë <sup>17</sup>

|                          | Municione   | Eksplzivë  | Armë              |
|--------------------------|-------------|------------|-------------------|
| Të plaçkitur më 1997     | 839,310,038 | 16,000,000 | 549,775           |
| Mars 1997 – Qershor 2005 | 118,134,222 | 1,539,828  | 222,918 or 40.54% |

Një amnisti e tretë në 2017-ën çoi në dorëzimin e 1,603 armëve zjarri, 1,558 granatave dhe mbi 580,000 fishekësh, duke theksuar çështjen e vazhdueshme të armëmbajtjes së paligjshme të përhapur mes qytetarëve.

**Krimi i organizuar:** Armët e zjarri e vjedhura gjatë trazirave të 1997 janë përfshirë në një numër të konsiderueshëm vrasjesh të lidhura me krimin e organizuar në Shqipëri. Armë të tilla si snajpera, pistoleta me silenciator dhe pushkë automatike janë mjaft të përdorshme në incidente të tilla, duke vënë në pah lidhjen mes armëve të paligjshme dhe dhunës nga krimi i organizuar.

**Këshillë:** Për informacion të mëtejshëm dhe më të thelluar për AVL-të në Shqipëri shikoni: [SEESAC](#) dhe [Buletin e Riskut të Iniciativës Botërore](#). Këto ofrojnë raporte të detajuara dhe përditësim për përpjekjet e Shqipërisë për të kontrolluar qarkullimin dhe ndikimin e AVL-ve.

## 1.4 Roli i medias në rritjen e ndërgjegjësimin për AVL-të

Armë të vogla, si pistoletat, pushkët, gjysmëmitralozat dhe armët e lehta, përfshirë granatat, mortajat dhe raketahedhëset, shumëfishojnë forcën dhe rrisin dhunën në shumë konflikte, nga krimet urbane deri te kryengritjet, luftërat civile dhe, siç do të trajtojmë edhe më vonë, dhunën me bazë gjinore. Aksesueshmëria e tyre, lehtësia në përdorim dhe lëvizshmëria i bën ato të shpeshta në dhunën e organizuar dhe të paorganizuar, duke ndezur konfliktet e tejzgjatura dhe rajonet e paqëndrueshme. Duke qenë të mirinformuar për AVL-të, gazetarët mund të bëjnë interpretime më të mira, të ofrojnë kontekst në kronikat e tyre për zonat e konfliktit, prevalencën e dhunës së armatosur në shoqëri, përhapjen e armëve dhe ndikimin e tyre në popullsinë civile, duke i dhënë audiencës mundësinë që kuptojë më mirë mënyrën se si këto armë rrisin tensionet dhe kontribuojnë në humbje jetësh, tensione shoqërore dhe ekonomike, humbje zhvillimi dhe rritje të shpenzimeve shëndetësore dhe shoqërore.

**Raportimi për AVL-të është një sfidë e rëndësishme për gazetarët, sidomos për sa i përket aksesit në të dhëna të besueshme, të kuptuarit e kompleksiteteve teknike të armëve dhe garantimit të sigurisë së burimeve.** Një prej vështirësive primare është mungesa e transparencës dhe të dhëna të sakta për transfertat e armëve. Shumë qeveri dhe organizata të përfshira në tregtinë e AVL-ve nuk publikojnë informacione të detajuara, duke vështirësuar punën e gazetarëve për sa i përket gjurmimit të fluksit të **armëve dhe identifikimit** të destinacionit përfundimtar. Po ashtu, tregtia e paligjshme e armëve, për nga natyra, është sekrete, dhe shpesh përfshin tregun e zi dhe aktorë të paautorizuar, të cilët komplikojnë përpjekjet për mbledhjen e të dhënave të verifikueshme.

<sup>17</sup> SEESAC. (2019). *Small Arms and Light Weapons, Their Ammunition and Explosives Control Strategy, 2019-2024, Albania*, p.9. Accessed November 24, 2024. [https://www.seesac.org/f/docs/Albania-1/ENG\\_Albanian\\_Strategy\\_on\\_Fire-arms\\_Control-24-06-2019.pdf](https://www.seesac.org/f/docs/Albania-1/ENG_Albanian_Strategy_on_Fire-arms_Control-24-06-2019.pdf)

Për t'u përballur me këto sfida, gazetarët duhet jo vetëm të familjarizohen me AVL-të dhe sfidat që ato sjellin, por po ashtu të kërkojnë vazhdimisht për informacione të sakta nga burime dhe institucione për përshkrimet teknike të AVL-ve. Këto pyetje janë:

- Ku prodhohen këto armë? Brenda vendit, në rajon apo jashtë tij?
- A ka informacion paraprak nëse armët janë të ligjshme apo të paligjshme?
- A ishte arma e zjarrit e regjistruar në emrin e viktimës, të autorit apo të ndokujt tjetër? Apo nuk ishte fare e regjistruar?
- Kanë njohuri autoritetet për marrëdhënie të mundshme midis viktimës dhe autorit? Nëse po, cila është ajo?

Edhe pse gazetarët nuk pritët të jenë ekspertë në fushën e AVL-ve, njohuritë mbi gjuhën teknike ndihmojnë në raportimin e saktë të AVL-ve. Kjo mund të jetë aq e thjeshtë sa marrja e fotove nga armët e lidhura me çështjen, të cilat u mundësojnë atyre që ta identifikojnë atë me saktësi, duke përdorur burime të hapura si Armët – Udhëzues AVL-ve ose Një Udhëzues Hyrës për Identifikimin e Armëve të Vogla dhe të Lehta dhe Municionet e Lidhura me to | Sondazhi i Armëve të Vogla. Me kalimin e kohës, gazetarët do të përfitojnë njohuri për llojet e ndryshme të armëve, përdorimin e tyre dhe do të jenë në gjendje të bëjnë raportime më të sakta dhe me më shumë informacion të thelluar. Pa to është e lehtë që të keqinterpretohen sistemet e armëve ose të anashkalohen detaje kritike, të cilat potencialisht çojnë në keqinformim. Të mësuarit në mënyrë të vazhdueshme dhe konsultimet me ekspertë të fushës janë thelbësore për raportim të qartë dhe të përgjegjshëm. Ky manual shërben si pikënisje me shpresën që do t'ju frymëzojë të vazhdoni diskutimet mes kolegësh dhe ekspertësh për rëndësinë e mbulimit të çështjeve që lidhen me AVL-të.

Garantimi i sigurisë së burimeve është një tjetër pengesë e madhe. Shumë individë që kanë njohuri direkte për trafikimin e AVL-ve dhe përdorimin e tyre mund të kenë frikë nga hakmarrja, sidomos në zonat e konfliktit ose shtetet autoritare. Gazetarët duhet të balancojnë nevojën për burime të besueshme me përgjegjshmërinë etike të mbrojtjes së tyre. Kjo shpesh përfshin përdorimin e mjeteve të komunikimit të enkriptuar dhe ndjekjen e protokolleve strikte të konfidencialitetit. Rreziku i ekspozimit të informatorëve ose kthimi i vetë atyre në objektiva e bën edhe më komplekse raportimin e kësaj fushe të ndjeshme.

Këshillë: Ka një larmi burimesh të disponueshme për të garantuar sigurinë e gazetarëve dhe masat që mund të ndërmerren për të mbrojtur veten dhe burimet tuaja. Shikoni:  
<https://www.osce.org/files/f/documents/d/7/85777.pdf>  
<https://cpj.org/wp-content/uploads/2020/05/guide.pdf>  
<https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000243986>

## 1.5 Raportimi etik dhe praktikat e mira

Gazetarët që raportojnë për tema të lidhur me AVL-të duhet të jenë të kujdesshëm ndaj sfidave etike për të siguruar mbulimin e tyre me saktësi, përgjegjshmëri dhe mosdëmtim. Raportimi etik për AVL-të kërkon një qasje të balancuar, që vendos si prioritet saktësinë, minimizon gjuhën sensacionale, mbron burimet dhe përqendrohet në pasojat e përhapjes së armëve të njerëzimit. Duke ndjekur këto parime, gazetarët mund të ndihmojnë në informimin e publikut në mënyrë të përgjegjshme, duke kontribuar në përpjekjet më të gjera për të ulur ndikimin e dëmshëm të AVL-ve.

Te praktikat e mira përfshihet:

### ***Ndjeshmëria ndaj viktimave***

Gjatë mbulimit të incidenteve që përfshijnë AVL-të, është thelbësore të tregoni përkujdesje gjatë trajtimit të historive të viktimave, duke siguruar respektimin e privatësisë dhe dinjitetit. Neni 1 i Kodit Shqiptar për Etikën e Gazetarëve thekson rëndësinë e respektimit të dinjitetit të individëve të ndikuar nga ndodhitë që përbëjnë lajm. Gjatë mbulimit të incidenteve që përfshijnë AVL-të, gazetarët inkurajohen të tregojnë dhimbshuri, duke siguruar ruajtjen e privatësisë së viktimave. Duke ndjekur këtë parim, gazetarët mund të shmangin dëmtime të mëtejshme ndaj popullsisë së cënueshme, duke ruajtur të drejtat e njeriut dhe dinjitetin, siç parashikohet në Kod. Kjo diskutohet më tej te Kapitulli 2.

### ***Jini të qartë dhe të saktë***

Një prej aspekteve më të rëndësishme në raportimin e AVL-ve është saktësia. Keqinformimi ose prezantimi i gabuar i armëve mund të ketë pasoja të rënda, sidomos kur bëhet fjalë për raportim nga zonat e konfliktit. Neni 5 i Kodit thekson se gazetarët duhet të synojnë për të vërtetën dhe saktësinë, duke shmangur shtrembërimin e fakteve. Në rastin e raportimit për AVL-të, kjo do të thotë përcaktim i saktë i armatimeve dhe prezantim i qartë i rrethanave për përdorimin e tyre. Emërtimi i gabuar i armëve të vogla, si ngatërrimi i një pushke automatike me një gjysmëmitaloz, mund të keqorientojë audiencën dhe të shtrembërojë të kuptuarit e situatës. Mund të keni nevojë të konsultoheni me ekspertë ushtarakë ose burime të specializuara për armët, që të qartësoni detaje të tilla.

### ***Shmangni gjuhën sensacionale***

Në mënyrë të pashmangshme AVL-të lidhen me dhunën, konfliktet dhe tragjeditë, çka e bën të lehtë përdorimin e gjuhës sensacionale gjatë raportimit të çështjeve të tilla. Neni 2 i Kodit thekson se gazetarët duhet të shmangin gjuhën sensacionale dhe të sigurohen se raportimi i tyre është i matshëm dhe i përgjegjshëm. Kryetutijt sensacional ose përshkrime të ekzagjeruara mund të zgjasin frikën, të keqinformojnë publikun dhe kanë potencialin të lartësojnë dhunën. Në vend të kësaj, shikoni koston njerëzore dhe pasojat me të gjëra sociale nga përhapja e armëve. Përdorimi i gjuhës sensacionale gjatë raportimit të tematikave të tilla mund të shkaktojë frikë, të kontribuojë në ciklin e keqinformimit dhe keqprezantimit duke përkeqësuar edhe më tej dhunën.

### ***Konteksti, konteksti, konteksti***

Ofroni kontekst të gjerë ndërsa synoni gazetari të saktë dhe të përgjegjshme. Neni 7 i Kodit i bën thirrje gazetarëve të ofrojnë kontekstin e nevojshëm gjatë raportimit të tyre për t'u siguruar se historitë janë domethënëse dhe të kuptueshme në tërë kompleksitetin e tyre. Duke ofruar kontekst për shkaqet historike dhe gjeopolitike të përhapjes së armëve në Ballkanin Perëndimor, gazetarët mund të ndihmojnë lexuesit të kuptojnë ndikimin e gjerë të AVL-ve përtej ngjarjeve aktuale që përbëjnë lajm. Konteksti e ndihmon audiencën të kuptojë jo vetëm aspektet teknike të armëve por edhe implikimet e gjera socio-politike të lidhura me përdorimin, përhapjen dhe ndikimin e tyre. AVL-të nuk janë thjesht armë; janë të ndërlidhura me një sërë çështjesh si siguria globale, të drejtat e njeriut, përshkallëzimi i konflikteve dhe krimi i organizuar. Pa ofruar mjaftueshëm kontekst, raportimi i AVL-ve thjeshtëzon së tepërmi çështje komplekse duke e lënë audiencën të kuptojë situatën në mënyrë sipërfaqësore. Për shembull, raportimi vetëm i numrave të armëve të trafikuar pa eksploruar arsyet pas tregtisë, përfituesit dhe ndikimit të tyre në popullsinë vendase rrezikon që të çoi dëm tërë lajmin.

### ***Globale, lokale apo diçka në mes?***

Është thelbësore të bëhet lidhja midis rasteve lokale të dhunës nga AVL-të dhe modeleve globale të trafikimit dhe përhapjes së armëve. Neni 6 i Kodit i kërkon gazetarëve të bëjnë lidhjen midis lajmeve

lokale dhe çështjeve më të gjera. Gjatë mbulimit të AVL-ve, gazetarët duhet të lidhin ndodhitë lokale me trendet globale, të tilla si përhapja e armëve në Ballkan dhe pasojat e tyre në nivelin ndërkombëtar. Ky kontekstualizim jo vetëm që informon publikun, por po ashtu promovon ndërgjegjësimin e tij për rolin që incidentet lokale luajnë në çështjet më të gjera të sigurisë ndërkombëtare.

Ofrimi i kontekstit historik dhe ndërkombëtar, si për shembull mënyra se si rajone të caktuara u shndërruan në qendra armësh për shkak të konflikteve të së kaluarës ose politikave ndërkombëtare, i mundëson lexuesve të kuptojnë implikimet e përgjithshme. Ndërlidhja midis ndodhive lokale dhe dinamikave botërore ndihmon në vendosjen e AVL-ve brenda shqetësimeve ndërkombëtare të sigurisë dhe përpjekjeve diplomatike, si traktatet e kontrollit të armëve. Duke përfshirë kontekst të saktë në raportimet e AVL-ve, jo vetëm që do të informoni por po ashtu do të rrisni angazhimin duke ofruar një panoramë më të mirë të çështjeve më të gjera, nga implikimet politike deri tek ato humanitare.

Ballkani Perëndimor, përfshirë Shqipërinë, u shndërrua në një qendër armësh për shkak të një sërë faktorësh të rëndësishëm gjeopolitik. Në 1997-ën, kolapsi e skemave piramidale çoi në plaçkitje masive të depove ushtarake, duke nxjerr në qarkullim civil dhe në treg të zi më shumë se 550,000 armë. Shpërbërja e Jugosllavisë në 1990-ën po ashtu rriti përhapjen e armëve, pasi rezerva u konfiskuan nga grupe paraushtarake ose u shitën nëpërmjet rrjeteve të krimit të organizuar. Pavarësisht përpjekjeve për çarmatim, një numër i konsiderueshëm armësh mbeti në duart e individëve, duke rritur trafikimin e paligjshëm të armëve në Evropën Perëndimore.<sup>18</sup>

Për shembull, armë nga Ballkani, si pushka automatike “Zastava M-70”, është raportuar të jetë përdorur në sulmin e bujshëm në Paris të nëntorit 2015 dhe në sulmin ndaj revistës “Charlie Hebdo” në 2015-ën.<sup>19</sup> Kostoja e armëve të zjarrit vë në dukje pabarazinë e kërkesës, pasi kallashnikovët kushtojnë 300-500 euro në Ballkan, ndërsa çmimi i tyre rritet deri në 2,000 euro në Evropën Perëndimore. Hulumtuesit nga Instituti Flamand për Paqe tregojnë se Ballkani shërben si rruga kryesore për kontrabandimin e armëve të paligjshme në Bashkimin Evropian (BE), ku ka më shumë armë zjarri të paligjshme në qarkullim, sesa armë në posedim të ligjshëm në shtete si Serbia, Kroacia, Bosnja dhe Shqipëria.

### ***Jini të kujdesshëm për zgjedhjet tua dhe përdorimin e burimeve***

Me shumë gjasa do të mbështeteni në një larmi burimesh, përfshirë zyrtarët qeveritarë, trafikuesit e armëve dhe individë të përfshirë në konflikte. Neni 8 i Kodit thekson rëndësinë e përdorimit të burimeve të besueshme. Në raportimin e AVL-ve, gazetarët duhet të sigurohen se verifikojnë saktësinë dhe besueshmërinë e informacioneve që vijnë nga burimet, sidomos ato të përfshira në trafikun e paligjshëm të armëve. Duke i besuar ekspertëve me emër të mirë, gazetarët mund të ulin riskun e shpërndarjes së informacioneve të rreme, sidomos kur merren me çështje të ndjeshme sigurie. Kjo diskutohet më tej në Kapitullin 2.

### ***Mbroni burimet tua***

Gjithmonë duhet të merrni masa për të mbrojtur burimet që mund të jenë në rrezik, si sinjalizuesit, individët që japin informacione nga mjedise të rrezikshme ose viktimat e dhunës. Neni 10 i Kodit u bën thirrje gazetarëve të mbrojnë burimet, sidomos gjatë hetimeve të ndjeshme si trafiku i armëve. Gazetarët që mbulojnë tregtinë e paligjshme të armëve duhet të jenë edhe më të kujdesshëm për të mbrojtur identitetin e sinjalizuesve, viktimave ose informatorëve, të cilët mund të jenë në rrezik. Metodat e sigurta të komunikimit dhe ruajtja e identiteteve mund të mbrojnë burimet nga shpagimi.

18 ReliefWeb, 2002, Albania, Kosovo, and Macedonia: Armed to the teeth, August 5. Retrieved from <https://reliefweb.int/report/albania/albania-kosovo-and-macedonia-armed-teeth>

19 Arapi, L., 2015, “The Balkan Route to Western Europe for Yugoslavia Guns”. Deutsche Welle (DW). December 3. <https://www.dw.com/en/the-balkan-route-to-western-europe-for-yugoslavia-guns/a-18896280>

### ***Brenda apo jashtë kamerave***

Mos lejoni burimet tuaja të flasin jashtë kamerave ose në mënyrë anonime, përveç rasteve kur kjo është e vetmja mënyrë për të marrë informacion. Neni 9 i Kodit Shqiptar të Etikës thekson se burimet duhet të citohen jashtë kamerave vetëm nëse është e nevojshme dhe gazetarët duhet të mbajnë përgjegjësi për verifikimin e informacionit. Por kini parasysh se, nëse bini dakord me këtë gjë, jo vetëm që jeni të detyruar nga ana etike që të respektoni çdo marrëveshje që keni bërë, por po ashtu jeni në pozitë të atillë ku duhet të gjeni një burim tjetër për të konfirmuar informacionin.

Në rastet e trafikut të armëve, ku informacioni mund të jetë konfidencial ose i ndjeshëm, është me rëndësi kritike që burimet të trajtohen me kujdes dhe përgjegjshmëri, duke u siguruar që marrëveshjet të respektohen dhe do të kërkohet verifikim i mëtejshëm nëpërmjet burimeve alternative.

### ***Mos harroni ndikimin njerëzor***

Lajmet nuk janë vetëm AVL-të, por edhe njerëzit e ndikuar. AVL-të nuk janë vetëm mjete lufte apo konflikti – ato kanë ndikim të jashtëzakonshëm në popullsitë civile, zgjatjen e cikleve të dhunës dhe cenimin e përpjekjeve për paqe. Neni 3 i Kodit thekson rëndësinë për t'u përqendruar tek aspekti njerëzor në çdo lajm. Për lajmet që lidhen me AVL-të, duhet të përqendroheni tek mënyra se si këto armë ndikojnë komunitetet, sidomos grupet e cënueshme si fëmijët, gratë dhe popullsitë e zhvendosura. Duke theksuar përpjekjet për çarmatim, iniciativat për të sjellë paqe dhe pasojat afatgjata të përhapjes së armëve, u shtoni kontekst të rëndësishëm lajmeve për AVL-të. Prandaj, jini të sigurt që të përfshini ndikimin njerëzor të AVL-ve në raportimet tuaja, pasi kështu i bëni ato më të thella. Diskutoni për mënyrat se si AVL-të kontribuojnë në dhunë, zhvendosje të popullsive dhe rritje të paqëndrueshmërisë brenda komuniteteve për t'i ofruar audiencës një vështrim më gjithëpërfshirës për rolin e armëve përtej statistikave.

### ***Balanconi sigurinë dhe interesin publik***

Raportimi për AVL-të shpesh kërkon ekspozimin e rrjeteve të tregtisë së paligjshme të armëve ose analizën e politikave shtetërore për kontrollin e armëve. Neni 4 i Kodit u kërkon gazetarëve të balancojnë interesin publik me sigurinë kombëtare. Gazetarët duhet të balancojnë të drejtën e publikut për t'u informuar me potencialin e një kërcënimi të sigurisë kombëtare. Megjithatë, ofrimi i informacioneve të tepërta për një hetim që është në vijim për armët ose zbulimi i operacioneve ushtarake mund të komprometojnë përpjekjet për të luftuar trafikun e paligjshëm të armëve. Duhet të punoni ngushtë me redaktorë dhe ekspertë ligjorë, për t'u siguruar se mbulimi nuk cenon kurrësi operacione të ndjeshme ndërsa vijoni ta mbani pushtetin përpara përgjegjësisë.

### ***Rrisni ndërgjegjësimin pa përhapur frikë***

Si gazetarë, keni fuqinë të ndikoni opinionin publik dhe politikën, kështu që është thelbësore të raportoni për AVL-të në një mënyrë që ka për të rritur ndërgjegjësimin për çështje të tilla, pa krijuar frikë të panevojshme. Neni 2 i Kodit e vë theksin tek promovimi i raportimit të përgjegjshëm dhe informativ dhe u bën apel gazetarëve të shmangin përhapjen e frikës së tepruar apo panikut. Gjatë rritjes së ndërgjegjësimit për trafikun e armëve, në vend që të krijojnë ankth të panevojshëm, gazetarët duhet të përqendrohen tek zgjidhjet dhe tek bashkëpunimi ndërkombëtar për të ulur përhapjen e armëve dhe të shmangin gjuhën nxitëse.

### ***Promovoni çarmatimin dhe përpjekjet për kontroll***

Raportimi juaj duhet të vërë në dukje përpjekjet për të ulur ndikimin e AVL-ve. Neni 7 i Kodit inkurajon gazetarët të mbrojnë paqen dhe praktikën etike gjatë raportimit. Kjo mund të përfshijë mbulimin e traktateve ndërkombëtare ose iniciativave nga organizata joqeveritare për të ulur fluksin e armëve. Duke promovuar përpjekje të tilla, gazetarët kontribuojnë në advokacinë për çarmatim global, duke inkurajuar debatin e bazuar në informacione për mënyrën e adresimit të përhapjes së armëve të vogla dhe të lehta.

## 1.6 Armët e Vogla dhe të Lehta në Shqipëri

Shqipëria ka një problem të madh për sa i përket armëmbajtjes pa leje dhe përhapjes së Armëve të Vogla dhe të Lehta (AVL). Konfliktet e trashëguara dhe kontrollat e dobëta shtetërore kanë kontribuar në disponueshmërinë e gjerë të armëve në vend. Kjo disponueshmëri rrit shkallën e krimit, përfshirë dhunën në familje dhe parashtron një sfidë të rëndësishme për sa i përket sigurisë dhe rendit publik.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë është e përkushtuar në parandalimin, kontrollin dhe uljen e përhapjes së armëve të paligjshme në përputhje me iniciativat, standardet dhe dokumentet rajonale dhe ndërkombëtare për kontrollin e AVL-ve, municioneve dhe eksplozivëve. Shqipëria u është bashkuar të gjitha marrëveshjeve ndërkombëtare për kontrollin e armëve, përfshirë: Traktatin e Tregtisë së Armëve, Programin e Veprimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Armët e Vogla dhe të Lehta, Protokollin e Armëve të Zjarrit dhe ka mirëpritur iniciativa rajonale për forcimin e kontrollit të AVL-ve në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në tërë rajonin.

Parlamenti i Shqipërisë ka miratuar një sërë ligjesh për armët<sup>20</sup>, të cilat synojnë të ofrojnë kontroll më efektiv të AVL-ve. Po ashtu, qeveria e Shqipërisë ka miratuar një sërë aktesh normative dhe udhëzimesh, që synojnë plotësimin e akteve ligjore nëpërmjet paketës së akteve nënligjore që lejojnë përdorimin e armëve në veprimtari të ligjshme, për kategorinë që plotëson kushtet dhe kriteret, por po ashtu ndëshkon qytetarët që synojnë të ushtrojnë dhe organizojnë veprimtari kriminale në këtë drejtim.

Në 2016-ën, Republika e Shqipërisë asgjësoi tepricën e armëve dhe municioneve të trashëguara nga sistemi i kaluar, duke u ndihmuar edhe nga organizata ndërkombëtare e shtete partnere. Masat për uljen e korrupsionit dhe krimin e organizuar ishin në zemër të reformave gjyqësore të miratuara në 2016-ën, ashtu si dhe krijimi i Komisionit Kombëtar të Armëve të Vogla dhe të Lehta më korrik 2017. Ky i fundit është përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për AVL-të, të cilat u miratuan më 6 shkurt 2019.

Lidhur me përputhshmërinë, Strategjia përmend në mënyrë eksplicite se i referohet ngushtë “Udhërrëfyesit për zgjidhje të qëndrueshme ndaj armëmbajtjes pa leje, keqpërdorimit dhe trafikimit të Armëve të Vogla dhe të Lehta (AVL) dhe municioneve në Ballkanin Perëndimor, deri në 2024” dhe monitoron plotësisht udhërrëfyesin dhe performancën e treguesve brenda objektivave kombëtarë dhe kuadrit të monitorimit të avancimit.<sup>21</sup> Në zbatim të kësaj strategjie dhe në përputhje me kriteret e BE-së, Shqipëria krijoi gjithashtu një pikë fokale të Armëve të Zjarrit, një qendër operationale dhe bashkëpunimi që heton të gjitha rastet që kanë të bëjnë me armët e zjarrit.

### 1.6.1 Përhapja e AVL-ve në Shqipëri

Pas rënies së regjimit komunist në fillim të viteve 1990 dhe gjatë trazirave civile të vitit 1997, sasi të mëdha armësh u plaçkitën nga depot ushtarake, duke çuar në disponueshmëri të gjerë të armëve të zjarrit. Për më tepër, Shqipëria është identifikuar si vendburim dhe vend tranzit për trafikun e paligjshëm të armëve, duke i komplikuar më tej përpjekjet për të frenuar përhapjen e AVL-ve. Kjo ka çuar në sfida të vazhdueshme në çarmatim dhe kontroll.

<sup>20</sup> Shikoni seksionin 1.6.2.

<sup>21</sup> UNDP (n.d.). Support to Albania's law enforcement authorities to strengthen firearms criminality, evidence management, and investigation capacities. United Nations Development Programme. Marrë më 8 dhjetor 2024, from <https://www.undp.org/albania/projects/support-albanias-law-enforcement-authorities-strengthen-firearms-criminality-evidence-management-and-investigation-capacities>

Gjatë trazirave të 1997-ës, më shumë se 550,000 armë zjarri janë raportuar të jenë plaçkitur nga depot ushtarake.<sup>22</sup> Vlerësohet se këto përfshijnë:

- 38,000 pistoleta
- 226,000 AK-47 (kallashnikovë)
- 25,000 mitraloza
- 2,400 raketahedhëse kundërtank
- 3,500,000 granata dore
- 3,600 tonë eksplozivë<sup>23</sup>

Në më pak se një javë, një numër kaq i lartë armësh, municionesh dhe eksplozivësh kaluan në mënyrë të paligjshme në duart e civilëve brenda Shqipërisë dhe më gjerë në rajon, duke u përshkallëzuar edhe më tej për shkak të vendndodhjes strategjike të shtetit pranë vendeve në konflikt si ish-Jugosllavia.<sup>24</sup> Këta faktorë gjeografikë dhe historikë e kanë bërë Shqipërinë pjesë të rrjeteve rajonale të trafikimit, duke komplikuar përpjekjet për çarmatim.

Pavarësisht iniciativave qeveritare si fushatat e çarmatimit vullnetar dhe miratimin e Strategjisë Kombëtare për kontrollin e AVL-ve, përlogaritjet se deri në 300,000 armë zjarri mbeten në duart e civilëve<sup>25</sup> dhe vijojnë të përbëjnë rrezik të madh për sigurinë publike.<sup>26</sup>

Raportet theksojnë se shpesh ka përfshirje armësh në krime të dhunshme, dhunë në familje dhe veprimtari të krimit të organizuar.<sup>27</sup> Në veçanti armët e zjarrit të paregjistruara krijojnë sfida të mëdha në zonat rurale dhe komunitetet e marginalizuara, ku zbatimi i masave të kontrollit është më i vështirë.<sup>28</sup> Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë, përfshirë SEESAC-un<sup>29</sup> dhe Programin e Zhvillimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNDP), ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në rritjen e kapaciteteve shqiptare për të menaxhuar AVL-të, megjithëse boshllëqet e zbatimit të ligjit dhe hapësirat nëpër kufij përbëjnë pengesa kritike.

Shqipëria është vendburim dhe vend tranzit për trafikun e paligjshëm të armëve. Vendndodhja gjeografike e bën atë një pikë kritike në tregtinë e paligjshme të armëve, veçanërisht brenda Ballkanit dhe drejt Evropës Perëndimore. Burimet e kufizuara dhe korrupsioni pengojnë përpjekjet për të kontrolluar kufijtë dhe për të luftuar trafikimin.

Ndonëse Shqipëria ka përparuar për sa i përket fuqizimit të kuadrit ligjor, zbatimi i tij mbetet jo konsistent. Burimet e kufizuara, korrupsioni dhe trajnimi i pamjaftueshëm për oficerët e zbatimit të ligjit minon përpjekjet për të kontrolluar përhapjen e AVL-ve.

22 Holtom, P. et.al., 2005.

23 Zhilla, F., & Lamallari, B., 2015, *Organised crime: Threat assessment in Albania*. Open Society Foundation for Albania. <https://doi.org/10.13140/RG.2.1.3825.6481>

24 Arsovska, J., 2019, "The rise of Balkan organized crime". In M. Natarajan (Ed.), *International and transnational crime and justice* (pp. 198–203). Cambridge University Press.

25 Davis, J., 2016, A European gun culture deadlier than America's. Politico, January 18. Accessed November 26, 2024. <https://www.politico.eu/article/the-european-nation-with-a-deadlier-gun-culture-than-the-us-albania/>.

26 OSCE Presence in Albania, 2023, *Presentation of awareness raising and communication strategy, action plan, and campaign on small arms and light weapons*. OSCE. June 6. Accessed November 24, 2024. [https://www.osce.org/presence-in-albania/545473#\\_ftn1](https://www.osce.org/presence-in-albania/545473#_ftn1).

27 SEESAC, 2019. *Small Arms and Light Weapons (SALW) Survey: Albania 2012 – 2016*. Accessed November 25, 2024. [https://www.seesac.org/f/docs/SALW-Surveys/web\\_Albania-SALW-Survey\\_ENG.pdf](https://www.seesac.org/f/docs/SALW-Surveys/web_Albania-SALW-Survey_ENG.pdf).

28 Global Initiative Against Transnational Organized Crime, 2021. *Unburying guns from Albania's past. Risk Bulletin* #7, April-May 2021. Accessed November 27, 2024. <https://riskbulletins.globalinitiative.net/see-obs-007/05-unburying-guns-from-albanias-past.html>.

29 Southeastern and Eastern Europe Clearinghouse for the Control of Small Arms and Light Weapons (SEESAC). About SEESAC. United Nations Development Programme (UNDP) and Regional Cooperation Council (RCC). Accessed November 27, 2024. <https://www.seesac.org/>.

Strategjia (2019 – 2024) dhe Plani i Veprimit (2019 – 2021) shoqërues njohin aspektet gjinore të kontrollit të AVL-ve dhe përmbajnë masa specifike për të përmirësuar reagimin institucional dhe atë politik ndaj keqpërdorimit të armëve të zjarrit në rastet e dhunës në familje dhe rastet e dhunës nga partneri intim. Strategjia po ashtu parashikon aktivitete që synojnë rritjen e pjesëmarrjes së grave në kontrollin e AVL-ve dhe përmirësimin e kapaciteteve të institucioneve kompetente për integrimin gjinor në politikat të kontrollit të AVL-ve.

Nga perspektiva gjinore, Policia e Shtetit ka vendosur kuota gjinore prej 50% për gratë në politikat e rekrutimit dhe ka nisur një fushatë për rritjen e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në forcat e policisë.

Burrat përbëjnë 82.5% dhe gratë 17.5% të viktimave nga incidentet me armë zjarri.

- Pasojat kanë qenë vdekjeprurëse për 20.5% të viktimave femra dhe 18.1% të viktimave meshkuj, të vrarë nga incidente me armë zjarri.
- 76% e viktimave gra u vranë me armë zjarri në shtëpitë, apartamentet ose oborrin e tyre.
- 57.1% e grave u vranë nga anëtarët e familjes me armë zjarri, ndërsa nuk ka raste të raportuara për burra të vrarë nga anëtarë të familjes me armë zjarri.
- 27.8% e grave të vrara nga partneri i tyre intim në 2015-ën dhe 2016-ën në Shqipëri është kryer me armë zjarri.
- 26.3% e incidenteve të dhunës në familje që përfshijnë armë zjarri kishin pasoja vdekjeprurëse.
- Burrat kryen 98.1% të incidenteve me armë zjarri, ndërsa gratë vetëm 1.9% të incidenteve.
- 20.9% e personave në Shqipëri u vra nga anëtarët e familjes. Nga viti 2012 deri në 2016-ën, 115 nga 550 vrasje të raportuara u krye nga anëtarët e familjes.
- Gratë tejkalojnë burrat si viktima të vrasjeve të kryera nga anëtarët e familjes me 62 gra (53.9%) dhe 53 burra të vrarë (46.1%). Dhuna në familje ndikon gratë dhe burrat, por modelet e viktimizimit janë të ndryshme.

70.5% e grave në Shqipëri janë vrarë nga anëtarët e familjes krahasuar me 11.5% të burrave të vrarë.

Ekspertët ngrenë alarmin se kjo fushë ka nevojë për konsolidim dhe fuqizim të mëtejshëm, në mënyrë që të krijohen politika për një kulturë të larmishme dhe jo diskriminuese, që inkurajon gratë dhe vajzat të marrin pjesë në operacionet ligjzbatuese dhe proceset domethënëse vendimmarrëse. Edhe kjo është e këshillueshme, ka shumë gjëra për t'u arrirë në praktikë. Është e rëndësishme të promovohet në mënyrë konkrete diversiteti gjinor në forcat e policisë dhe fuqizimi i tërë personelit për t'u rritur profesionalisht dhe nga ana manaxhierale brenda strukturës.

### 1.6.2 Çështje ligjore

Kuadri ligjor dhe institucional në fushën e kontrollit të AVL-ve dhe eksplozivëve në Republikën e Shqipërisë përfshin pjesët vijuese të legjislacionit<sup>30</sup>:

30 SEESAC, 2019, *Small Arms and Light Weapons, Their Ammunition and Explosives Control Strategy, 2019-2024, Albania*, p. 12. Accessed November 24, 2024. [https://www.seesac.org/f/docs/Albania-1/ENG\\_Albanian\\_Strategy\\_on\\_Fire-arms\\_Control-24-06-2019.pdf](https://www.seesac.org/f/docs/Albania-1/ENG_Albanian_Strategy_on_Fire-arms_Control-24-06-2019.pdf).

- **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar**  
Përcakton kuadrin ligjor dhe parimet e qeverisjes të autoritetit shtetëror, përfshirë rregullimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e AVL-ve dhe eksplozivëve për të garantuar sigurinë publike.
- **Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 7895, i datës 27.1.1995**  
Jep përkufizime të veprave penale, përfshirë ato të lidhura me armëmbajtjen pa leje, trafikimin dhe përdorimin e AVL-ve dhe eksplozivëve dhe parashikon ndëshkime për të parandaluar dhe trajtuar veprime të tilla.
- **Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 7905, i datës 21.3.1995**  
Përshkruan kuadrin e procedurave për hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e veprave penale, përfshirë ato të AVL-ve dhe eksplozivëve, duke siguruar proces të drejtë dhe me përgjegjësi ligjore.
- **Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ligji nr. 9887, i datës 10.3.2008, i ndryshuar nga ligji nr. 48/2012, i ndryshuar nga ligji nr. 120/2014.**  
Përcakton kuadrin ligjor për ruajtjen e të dhënave personale, përfshirë dispozitat përkatëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave në veprimtaritë që lidhen me AVL-të dhe eksplozivët, duke siguruar privatësinë dhe përputhjen me standardet ndërkombëtare.
- **Për Policinë e Shtetit, ligji nr. 82/2024, i ndryshuar**  
Përcakton rolet, përgjegjësitë dhe kuadrin operacional të Policisë së Shtetit në garantimin e rendit publik dhe sigurisë, përfshirë kontrollin, menaxhimin dhe parandalimin e aktiviteteve të paligjshme që lidhen me AVL-të dhe eksplozivët.
- **Për Marrëveshjet Ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, ligji nr. 43/2016**  
Përcakton procedurat për negocimin, ratifikimin dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, përfshirë ato të lidhura me kontrollin e AVL-ve dhe eksplozivëve, duke siguruar përafrimin me standardet dhe angazhimet ndërkombëtare.
- **Për Kontrollin Kufitar, ligji nr. 71/2016**  
Rregullon menaxhimin dhe sigurinë e kufijve, përfshirë masat për parandalimin e trafikimit të paligjshëm të AVL-ve dhe eksplozivëve, ndërkohë që siguron përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë.
- **Për Armët, ligji nr. 74/2014**  
Përcakton kuadrin ligjor për kontrollin, posedimin, prodhimin, ruajtjen dhe tregtinë e AVL-ve, synon të parandalojë keqpërdorimin dhe të garantojë sigurinë publike në përputhje me standardet ndërkombëtare.
- **Për Përdorimin e Armëve të Zjarrit, ligji nr. 72/2014**  
Rregullon kushtet, rrethanat dhe procedurat për përdorimin e armëve të zjarrit nga subjektet e autorizuar, duke garantuar përputhje me standardet ligjore dhe ato të të drejtave të njeriut.
- **Për Gjuetinë, ligji nr. 10253, i datës 11.3.2010, i ndryshuar**  
Rregullon kushtet për gjueti, përfshirë përdorimin dhe kontrollin e armëve dhe eksplozivëve në veprimtaritë e gjuetisë, duke siguruar përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të ruajtjes së jetës së egër.

- **Për Përdorimin Civil të Lëndëve Plasëse në Republikën e Shqipërisë, ligji nr. 9126, i datës 29.7.2003**, i ndryshuar nga **ligji nr. 10388**, i datës 3.3.2011 dhe **ligji nr. 73/2014**.  
Rregullon përdorimin civil të eksplozivëve, lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrëve, duke përcaktuar standardet e sigurisë dhe masat e kontrollit për të parandaluar keqpërdorimin dhe garantimin e sigurisë publike.
- **Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Etiketimin e Eksplozivëve Plastike për Qëllime Zbulimi, ligji nr. 9020, i datës 6.3.2003**.  
Ratifikon aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e lartpërmendur, duke synuar rritjen e sigurisë globale nëpërmjet lehtësimit të eksplozivëve plastike.
- **Për Kontrollin Shtetëror të Transferimeve Ndërkombëtare të Mallrave Ushtarake dhe të Artikujve e Teknologjive me Përdorim të Dyfishtë, ligji nr. 46/2018**.  
Rregullon kontrollin shtetëror mbi transferimet ndërkombëtare të mallrave ushtarake, teknologjive dhe artikujve me përdorim të dyfishtë në Republikën e Shqipërisë, duke siguruar përputhje me standardet ndërkombëtare për mospërhapje dhe protokollet e sigurisë.
- **Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjet evropiane “Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme (ADR) dhe protokollin e nënshkrimit” Nr. 9272, i datës 16.9.2004**.  
Ka të bëjë me aderimin e shtetit në Marrëveshjen e lartpërmendur dhe zbatimin e protokollit, duke synuar rregullimin e transportit të sigurt të mallrave të rrezikshme, përfshirë eksplozivët përtej kufijve.
- **Për Ratifikimin e Traktatit për Tregtinë e Armëve, ligji nr. 6/2014, i datës 30.1.2014**.  
Ratifikon Traktatin e Tregtisë së Armëve në Republikën e Shqipërisë, duke përcaktuar një rregullore për tregtinë ndërkombëtare të armëve konvencionale, me synim promovimin e transparencës dhe parandalimin e diversionit të armëve nga marrës të paautorizuar.
- **Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 102/2014**  
Përcakton kuadrin ligjor për rregullimin e procedurave doganore, përfshirë kontrollin e mallrave të importuar dhe të eksportuar, të tilla si AVL dhe eksplozivë, për të siguruar pajtueshmërinë me ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare.
- **Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 275, i datës 1.4.2015, i cili miraton rregulloren për kushtet dhe rregullat e sigurisë së armëve**.  
Përcakton rregulloren për kushtet dhe rregullat e sigurisë së armëve, duke listuar masat e nevojshme të sigurisë për përdorimin, ruajtjen dhe transportin e armëve, përfshirë ato që lidhen me AVL-të dhe eksplozivët.
- **Ligji “Për mbledhjen e armëve dhe municioneve ushtarake” (1998) dhe ligji “Për mbledhjen e armëve, municioneve dhe materialeve të tjera ushtarake” (2003)** ishin masat e para që pasuan ngjarjet e 1997-ës kur armët, municionet, granatat dhe pajisjet ushtarake u plaçkitën nga depot shtetërore në Shqipëri. Këto ligje krijuan kuadrin për një sërë amnistish për dorëzimin vullnetar të armëve, duke synuar të parandalojnë ndëshkimin masiv të qytetarëve, duke u ofruar atyre mundësinë të dorëzojnë armët shtetërore në posedim të paligjshëm. Amnistia e parë zgjati nga gushti 1998 deri më gusht 2002. Gjatë kësaj kohe, ligji nr. 8388, i datës 5 gusht 1998 “Për mbledhjen e municioneve dhe armëve ushtarake”, u finalizua dhe u miratua. Ky ligj përcaktoi parimet dhe

metodat për dorëzimin vullnetar të armëve, duke prezantuar një sistem regjistrimi për disa kategori biznesesh dhe përcaktoi metodat që do të përdoreshin nga policia për mbledhjen e armëve.

- Amnistia e dytë u hartua në dhjetor 2002 dhe u pasua me miratimin e saj më 6 mars 2003 sipas ligjit nr. 9018 “Për mbledhjen e armëve, municioneve dhe pajisjeve të tjera ushtarake”. Ky ligj ndante të njëjtat parime, detyra dhe objektiva për personelin policor e ushtarak dhe ruante të njëjtën strukturë për komisionet e mbledhjeve të armëve në Shqipëri. Mbeti në fuqi deri më 31 maj 2005.<sup>31</sup> Megjithatë, ekziston një akt nënligjor për çaktivizimin që mbetet në fuqi dhe ofron një mundësi tjetër për kontrollin e përhapjes së AVL-ve.

### 1.6.3 Politika dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

Qeveria shqiptare është e angazhuar në një sërë iniciativash për çarmatim dhe kontroll të armëve, shpesh me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare si OKB-ja dhe BE-ja. Këto përpjekje përfshijnë përmirësimin e kuadrit legjislativ, përmirësimin e kontrolleve kufitare dhe zhvillimin e fushatave të ndërgjegjësimit për rreziqet nga armët e paligjshme të zjarrit.

#### Rast studimi: Raportimi për sjellje të pahijshme të policisë dhe AVL-të në Evropën Qendrore

##### Konteksti

Një media në Evropën Qendrore zhvilloi një investigim për sjellje të pahijshme të policisë lidhur me keqpërdorimin e AVL-ve. Investigimi nxori në pah një sërë rastesh ku oficerët e policisë janë përfshirë në shitje të paligjshme të armëve të konfiskuara, të cilat më pas përfundonin në duart e grupeve kriminale.

##### Sfidat

Gazetarëve iu desh të tejkalonin rezistencën institucionale, përfshirë refuzimin për t’iu përgjigjur pyetjeve nga ana e departamenteve të policisë si dhe kërcënime ligjore. Po ashtu iu desh të verifikonin informacione nga një sërë burimesh anonime, të cilat kërkonin kontroll të kujdesshëm të fakteve dhe prova.

##### Rezultati

Investigimi çoi në marrjen e masave disiplinore ndaj një sërë oficerësh policie dhe në një hetim më të gjerë në menaxhimin e armëve të zjarrit të konfiskuara nga agjencitë ligjzbatuese. Presioni publik gjithashtu e detyroi qeverinë të rishqyronte dhe reformonte politikën për sjelljen e policisë dhe rregulloret për armët e zjarrit.

##### Mësimet kyç

- Rëndësia e kontrollit të detajuar të fakteve dhe provave gjatë punës me akuza të ndjeshme.
- Strategji efektive për vendosjen e institucioneve publike përpara përgjegjësive nëpërmjet gazetarisë.
- Potenciali i gazetarisë investigative për të sjellë ndryshime sistematike të praktikave ligjzbatuese.

31 For an exhaustive review of SALW legislation and regulatory frameworks up to 2005, the following report is particularly useful: Holtom, P., et al., 2005. *Turning the page: Small arms and light weapons in Albania*. Report on small arms and security in South Eastern Europe, Center for Peace and Disarmament Education and Saferworld. Available at: <https://www.files.ethz.ch/isn/15132/Albania.pdf>

For updates beyond 2005 see: *Albania 2023 report: Commission staff working document*. [SWD(2023) 690 final]. Accompanying the communication on EU enlargement policy. Available at: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania\\_report\\_2023.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2023.pdf).

*Albania 2020 report: Commission staff working document*. [SWD(2020) 354 final]. Accompanying the communication on EU enlargement policy. Available at: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf). For the latest analysis of the SALW control framework see: UNDP, 2023. *Western Balkans SALW Control Roadmap MPTF Project Document*. Available at: [https://mptf.undp.org/sites/default/files/documents/2023-10/prodoc\\_rev\\_gtw\\_231003\\_0.pdf](https://mptf.undp.org/sites/default/files/documents/2023-10/prodoc_rev_gtw_231003_0.pdf).

## Kapitulli 2 Dhuna me bazë gjinore (DhBGj) dhe ndërlidhja e saj me AVL<sup>-në</sup>

### 2.1 Çfarë është DhBGj-ja

Çfarë është DhBGj-ja dhe pse dhuna me bazë gjinore duhet parë në kontekstin e AVL-ve? Përfshirja e DhBGj-së në diskutimet për raportimin e AVL-ve u lejon gazetarëve të ofrojnë një panoramë më të plotë të ndikimit të përhapjes të armëve të zjarrit te njerëzit, përtej aspekteve teknike apo politike. Është thelbësore të rritet ndërgjegjësimi dhe të zhvillohet diskursi publik për kontrollin e armëve dhe të drejtat e njeriut.

Por përpara se të analizojmë ndërlidhjen mes DhBGj-së dhe AVL-ve, le të shikojmë nga afër DhBGj-në – se çfarë është dhe si është situata e DhBGj-së në Shqipëri; se cilat janë disa prej praktikave të mira për gazetarët në raportimin e DhBGj-së dhe cilat janë disa prej konsideratave ligjore dhe etike që gazetarët duhet të kenë parasysh. Ky kapitull do të shqyrtojë këto pyetje dhe do të ofrojë këshilla të vyera.

#### **Përkufizim kyç: Dhuna me bazë gjinore**

Veprimet e dëmshme ndaj individëve në bazë të gjinisë së tyre. Përfshin abuzimin fizik, seksual dhe psikologjik. Shpesh ndodh në kontekste ku ka çekuilibër të fuqive.

Dhuna me bazë gjinore është një term përmbledhës nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, Këshilli i Evropës dhe agjenci të tjera ndërqeveritare që i referohen dhunës ndaj një individi në bazë të seksit biologjik ose identitetit gjinor të tyre. Përfshin kategori të tilla si dhuna psikologjike dhe fizike, sulmet dhe ngacmimet seksuale, martesat me forcë, mutacioni gjenital femëror, aborti dhe sterilizimi me forcë, kufizimi ekonomik dhe arsimor dhe sulmet ndaj personave transgjinerë. Kini parasysh se dhuna me bazë gjinore është një term më i gjerë se dhuna ndaj grave.

Raportimi për DhBGj-në kërkon që gazetarët të kuptojnë mirë faktorët kompleksë, që çojnë në dhunë ndaj grave, vajzave dhe identiteteve të tjera gjinore të marginalizuara. Gazetarët që mbulojnë DhBGj-në duhet të shkojnë përtej raportimit të thjeshtë të incidenteve, duke synuar të paraqesin kontekstin, përfshirë kuadrin shoqëror, kulturor dhe ligjor që lejon shkaktimin e kësaj dhune. Raportimi i saktë për DhBGj-në përfshin të kuptuarit e rolit patriarkal, pabarazive gjinore dhe normalizimit të dhunës brenda marrëdhënieve, komuniteteve dhe institucioneve. Ky kontekst është tepër i rëndësishëm për të ndihmuar audiencën të kuptojë modelet e gjera që e bëjnë DhBGj-në një çështje sistematike, më shumë se veprime të izoluar dhune.

Nëpërmjet raportimit të përgjegjshëm për DhBGj-në, gazetarët jo vetëm që informojnë publikun, por po ashtu luajnë rol kritik në advokacinë për ndryshime politike dhe rritje të ndërgjegjësimit për nevojën për reforma ligjore dhe shoqërore për të mbrojtur grupet e cënueshme.

## 2.2 Dhuna me bazë gjinore në Shqipëri

### Konteksti

Shqipëria vijon të vuajë norma të larta të dhunës në familje, ndërkohë që një studim i 2023-it tregon se 53% e grave shqiptare kanë përjetuar një formë dhune në familje. Normat kulturore, traditat, rolet strikte gjinore, stereotipat si dhe stigma që lidhet me dhunën me bazë gjinore dhe përdhunimin çon në një shkallë jashtëzakonisht shumë të ulët raportimesh, duke përbërë një sfidë serioze në luftën kundër DhBGj-së në Shqipëri.<sup>32</sup> Prania e armëve të zjarrit në ambientet shtëpiake rrit në mënyrë të konsiderueshme riskun nga dhuna vdekjeprurëse.

DhBGj-ja ka rrënja të thella në traditat dhe zakonet patriarkale, të cilat për një kohë të gjatë në Shqipëri kanë formësuar identitetin dhe rolet e ngurta gjinore, autoritetin patriarkal, ndjekjen e një sistemi nderi dhe turpi, zakonet e rendit hierarkik brenda familjes dhe kontrollin e familjes ndër breza.<sup>33</sup>

Qëndrime të tilla tradicionale patriarkale, stereotipat dhe role të ngurta gjinore mbeten mjaft të përhapura në Shqipëri, duke kontribuar në pabarazi gjinore në të gjitha sferat e jetës shoqërore dhe ekonomike si dhe në prevalencën e DhBGj-së. Në këtë drejtim, gratë dekurajohen nga pjesëmarrja në forcën punëtore. Në 2023-in, gratë përbënin 52.8% të forcës punëtore, ndërsa burrat përbënin 67.7% të saj.<sup>34</sup> Në 2019-ën, Shqipëria renditej e 42-ta mes 162 shtetesh në Indeksin e Pabarazisë Gjinore.<sup>35</sup>

Janë po ashtu të dukshme normat e ngulitura shoqërore që formojnë qëndrimet dhe zgjasin dhunën me bazë gjinore, pasi gjysma e grave të pyetura në një sondazh në 2019-ën raportuan se komunitetet e tyre vijonin ta shikonin dhunën në familje si një çështje private, që nuk duhet të përfshijë ndërhyrje nga jashtë (52.2% e grave të moshës 18-74 vjeç mendonin se dhuna në familje mes bashkëshortëve shihet si një çështje private, ndërsa 46.5% mendonin se gratë duhet të tolerojnë një fare dhune për të mbajtur familjen të bashkuar). Po ashtu, 1 në 3 gra (27.5%) raportuan se anëtarët e komunitetit shpesh besonin se gratë janë pjesërisht për t'u fajësuar për dhunën që përjetojnë.<sup>36</sup>

Gjithmonë merrni pëlqimin e burimeve tuaja. Që prej fillimit duhet të bini dakord për mënyrën se si viktimat do të identifikohen dhe nëse zërat e tyre dhe/ose fotografitë mund të përdoren. Shpjegojuni qëllimet dhe përgatitni burimet tuaja për atë që i pret më pas. Jini të gatshëm të adresoni çdo shqetësim të tyre. Shpjegojuni të intervistuarve mënyrën se si do të përdoret informacioni, ku do të publikohet historia dhe ndonjë pasojë të mundshme nga publikimi i intervistës; si dhe kur do të kontaktoni autorin (nëse është i njohur) apo autoritetet e tjera. Nëse intervistat përmbajnë të mbijetuar të DhBGj-së, sigurohuni se e kanë kuptuar që do të mbesin anonimë dhe pjesë të intervistës mund të priten nëse dëshirojnë.

#### **Sfida**

- Balanconi të drejtën e publikut për të ditur me nevojën për të mbrojtur individët e cenueshëm.

#### **Strategji për t'u ndjekur për të tejkaluar këtë sfidë**

- Përdorni anonimitetin dhe pseudonimet nëse është e nevojshme;
- Merrni pëlqimin e mirinformuar;
- Përqendrohuni në çështje më të gjera dhe sistemike;
- Jini të ndjeshëm për mënyrën se si do të formuloni historinë.

### *Mbroni burimet e cenueshme*

Në intervista me individë të cenueshëm, si të mbijetuar të DhBGj-së ose njerëzit që jetojnë në zonat e konfliktit, janë një sërë hapash që duhen ndjekur për të mbrojtur identitetin dhe privatësinë e tyre. Konsideroni përdorimin e pseudonimeve ose maskimin e detajeve të identitetit të tyre për të garantuar sigurinë e tyre. Jini të kujdesshëm të mos tregoni identitetin e tyre, pasi kjo mund t'i vendosë ata në risk për hakmarrje nga autorët ose autoritetet.

### *Jepuni burimeve tuaja më shumë kontroll*

Lejoni burimin tuaj të diktojë kohën dhe vendin e intervistave dhe, nëse është e nevojshme, ndajini ato në disa takime. Burimi juaj mund të dëshirojë të ketë dikë me vete gjatë intervistës - një këshilltar, një avokat ose një mik. Duhet ta respektoni këtë dëshirë. Nëse ndieni se burimi juaj po lodhet, stresohet ose shqetësohet, ndërpriteni intervistën dhe caktoni një datë tjetër për ta vijuar. Mos bëni dëm!

### *Bëni pyetje të hapura*

Përdorni pyetje të hapura që u lejojnë të intervistuarve të ndajnë përvojat e tyre pa u ndier sikur po merren në pyetje. Në vend që të pyesni "A përdori armë partneri juaj?", pyetni: "A mund të na përshkruani se si armët e zjarrit ndikuan në situatën tuaj?" Kjo qasje u lejon të intervistuarve të japin përgjigje të hollësishme me fjalët e veta, duke e bërë historinë më të pasur dhe më personale.

### *Përqendrohuni si tek jeta, ashtu dhe tek vdekja*

Gjatë mbulimit të historive që përfshijnë një vdekje, zakonisht e dimë se si ka vdekur personi. Nuk dimë shumë për jetën e tyre para këtij çasti. Bëni pyetje rreth jetës së personit. Kjo siguron humanizimin e këtyre personave në të tilla raste.

### *Jini të kujdesshëm për dinamikat e pushtetit*

Intervistat që lidhen me AVL-të dhe DhBGj-në, mund të mbartin dinamika pushteti midis intervistuesve dhe të intervistuarve, sidomos nëse i intervistuari është një i mbijetuar. Pranojini këto dinamika dhe sigurohuni që i intervistuari ka kontroll mbi diskutimin. Mos i ndërprisni dhe jepuni hapësirë dhe kohë që t'u përgjigjen pyetjeve sipas mënyrës së tyre.

### *Kontrolloni faktet dhe verifikoni informacionin*

Gjatë intervistimit me ekspertë, zyrtarë dhe advokues, sigurohuni që të kontrolloni pretendimet dhe statistikën e tyre. Çështjet e DhBGj-së dhe AVL-ve shpesh përmbajnë të dhëna të ndjeshme dhe raportimi i pasaktë i tyre mund të keqorientojë audiencën ose dëmtojë burimet. Kontrolloni disa herë pretendimet faktike ose statistikën nga burime dytësore si raportet zyrtare ose institucionet kërkimore si Sondazhi i Armëve të Vogla.

### *Ofroni burime mbështetëse*

Nëse jeni duke intervistuar një të mbijetuar të DhBGj-së, jepuni informacione për të kontaktuar shërbimet mbështetëse, si strehët lokale për dhunën në familje ose shërbime këshillimi. Duke u treguar atyre se ku mund të gjejnë ndihmë nëse i nevojitet, tregoni përkujdesje dhe përgjegjshmëri.

## **3.5 Raportimi i informuar për traumën**

Për t'u siguruar se raportimi i AVL-ve dhe DhBGj-së është i informuar për traumën, gazetarët duhet t'i qasen punës së tyre, duke kuptuar mënyrën se si ngjarjet traumatike mund të ndikojnë të mbijetuarit dhe të formësojnë ndërveprimet e tyre me median. Duke zbatuar këto praktika të informuara për traumën, gazetarët mund të sigurohen se raportimi i AVL-ve dhe DhBGj-së është i përgjegjshëm dhe me respekt, duke minimizuar dëmin dhe duke ngritur zërin e të mbijetuarve.

Këtu gjeni strategjitë kyç për t'u siguruar se raportimi juaj është me ndjeshmëri për traumën.

### *Jini të ndjeshëm me gjuhën dhe formulimin*

Gjuha e përdorur në raportimin e informuar për traumën duhet të jetë neutrale, plot respekt dhe inkurajuese. Shmangni përdorimin e gjuhës sensacionale për dhunën ose atë që i ul të mbijetuarit tek niveli i traumës së tyre. Në vend që të përqendroheni vetëm te viktimizimi, vini në dukje fuqinë e tyre dhe përpjekjet e bëra për ta rimarrë jetën nën kontroll. Shmangni detajet grafike ose gjuhën ngacmuese që mund të ritraumatizojë të mbijetuarit dhe lexuesit, të cilët kanë përjetuar dhunë të ngjashme.

### *I mbijetuar, viktimë apo diçka tjetër*

Një prej sfidave të para që ka gjasa të përballen gazetarët gjatë raportimit të DhBGj-së, është mënyra se si do t'i referohen dikujt i cili ka qenë subjekt i DhBGj-së. Gjuha e përdorur në raportimin e DhBGj-së duhet të jetë e kujdesshme dhe precize. Shmangni rrëfimet që fajësojnë viktimën dhe sigurohuni që kryetitulli dhe historitë të mos përforcojnë stereotipat ose idetë e gabuara. Disa gazetarë këshillojnë kundër përdorimit të fjalës viktimë, ndërkohë që paralajmërojnë kundër hamendësimit se fjala i/e mbijetuar është alternativa më e mirë. Pra, çfarë duhet të bëjnë gazetarët? Dëgjoni gjuhën që përdorin vetë të intervistuarit për të përcaktuar veten e tyre dhe ndiqeni atë. Mundeni po ashtu të pyesni burimin tuaj për preferencat e tyre.

E njëjta gjë vlen edhe për termin autor. Shumë njerëz abuzohen nga të afërm ose të njohur, kështu që referojuni autorëve me termin me të cilin ata janë mësuar – babai i tyre, daja/xhaxhai i tyre, i njohuri i tyre. Për shembull, duke ndjekur gjuhën e përdorur nga burimet do ta keni më të lehtë të mos i kategorizoni ato. Kjo po ashtu do të rezultojë në histori më nuanca më të sakta. Duke u larguar nga binari abstrakt viktimë-autor në raportimin tuaj, do të keni mundësinë të hulumtoni realitetet komplekse, të cilat shpesh janë të qenësishme në dhunën seksuale dhe pasojat e saj.

#### **Sfida**

- Shmangni përforsimin e stereotipave të dëmshëm ose narrativat që fajësojnë viktimën.

#### **Strategji për t'u ndjekur për të tejkaluar këtë sfidë**

- Fokusohuni në vendosjen e autorëve dhe sistemeve përpara përgjegjësive. Përfshini zërat e të mbijetuarve, advokuesve dhe ekspertëve, duke u siguruar se dinjiteti dhe privatësia e të mbijetuarve do të respektohet gjatë gjithë kohës.

#### *Jepuni të mbijetuarve kontroll mbi rrëfimin*

Të mbijetuarit duhet të kenë të drejtë të plotë për mënyrën se si rrëfehen historitë e tyre. Lejojini ata të shprehin përvojat me fjalët e tyre dhe të kontrollojnë se cilat pjesë të historive të tyre do të ndahen me publikun. Pranoni se trauma mund të ketë ndikim te kujtesa dhe aftësitë e tyre konjitive, prandaj lini hapësirë për gjëra që ndoshta nuk përputhen me njëra-tjetrën dhe mos u ushtroni presion të mbijetuarve duke i kërkuar për detaje ose afate kohore specifike. Kontaktojini sërish për t'u dhënë atyre mundësinë të korrigjojnë çdo detaj që mund të dëshirojnë të ndryshojnë pasi të kenë reflektuar.

#### *Krijoni një atmosferë të sigurt dhe komode*

Kur intervistoni të mbijetuar, krijoni një mjedis që i fal ndjesinë e sigurisë dhe mbështetjes. Kjo mund të përfshijë zgjedhjen e një vendi të rehatshëm dhe privat për intervistën dhe lejimin e pushimeve të shpeshta. Tregoni empati dhe durim në çdo bisedë, duke pranuar se trauma mund të ndikojë në ritmin dhe rrjedhën e komunikimit. Gjithmonë sigurojini të mbijetuarit se nuk janë të detyruar t'u përgjigjen asnjë pyetjeje për të cilën nuk ndihen mirë.

#### *Shmangni ritraumatizimin*

Në raportimin tuaj jini të kujdesshëm për mundësinë e ritraumatizimit. Duke u kërkuar në mënyrë të vazhdueshme të mbijetuarve që të rijetojnë traumën e tyre dhe të hyjnë në detaje grafike, mund të shkaktoni dëme emocionale. Përqendrohuni në pyetje që fuqizojnë të mbijetuarit, duke i lejuar ata të reflektojnë për shërimin e tyre, sistemet mbështetëse që kanë marrë dhe informacione që dëshirojnë të ndajnë me të tjerë. Jepuni hapësirë që të flasin për çështje sistematike më të gjëra që mendojnë se janë të rëndësishme, si reformat ligjore ose qasjet shoqërore.

**Sfida**

- Sigurohuni që të mbijetuarit nuk do të ritraumatizohen.

**Strategji për t'u ndjekur për të tejkaluar këtë sfidë**

- Shmangiuni praktikave sulmuese dhe pa ndjeshmëri në raportim;
- Përdorni gjuhë që përqendrohet tek të mbijetuarit;
- Siguroni pëlqimin e vetëdijshëm për intervistat;
- Shmangiuni gjuhës sensacionale.

*Njihni limitet e rolit tuaj*

Pranoni se jeni gazetarë e jo terapistë apo këshilltarë. Roli juaj është të raportoni dhe jo të ofroni mbështetje psikologjike. Megjithatë, mund të lidhni të mbijetuarit me burime të përshtatshme, si strehët lokale për viktimat e DhBGj-së, ndihmën ligjore ose shërbimet e këshillimit. Nëse një i mbijetuar tregon shenja stresi gjatë intervistës, jini të përgatitur për të ndalur diskutimin dhe të ofroni ndihmë, përfshirë aksesin në shërbime mbështetëse.

*Kontrolloni për dëme potenciale përpara publikimit*

Para se të publikoni një histori, vlerësoni nëse ndonjë pjesë e raportimit mund ta vërë të mbijetuarin në rrezik për dëme të mëtejshme, përfshirë hakmarjen, stigmatizimin ose ngacmimin. Merrni në konsideratë nëse detaje të tilla si vendndodhja, dinamikat familjare ose karakteristikat identifikuese duhet të mbahen të fshehta për të mbrojtur privatësinë dhe sigurinë e tyre. Konsultohuni me të mbijetuarin nëse ka ndonjë ndryshim që ndikon në informacionin e ndjeshëm që ata kanë ndarë.

*Bashkëpunoni me ekspertë të traumës*

Kur mbuloni tema komplekse si DhBGj-ja dhe AVL-të, konsultohuni me ekspertë të traumës, siç janë psikologët, këshilltarët ose punonjësit socialë, për të fituar njohuri se si ndikon trauma tek individët dhe si ta hartoni më së miri raportimin tuaj. Këta ekspertë mund të ofrojnë udhëzime mbi teknikat e intervistimit dhe t'ju ndihmojnë për t'u siguruar se raportimi juaj nuk do të dëmtojë pa dashje të mbijetuarit.

*Praktikoni përkujdesjen vetjake*

Mbulimi i DhBGj-së mund të jetë i vështirë emocionalisht, prandaj është e rëndësishme të kujdeseni për veten. Bisedoni me kolegët rreth historive që po punoni. Kjo jo vetëm që ju jep mundësi për të shprehur mendimin tuaj, por gjithashtu ju jep një mundësi për të diskutuar dhe kuptuar mënyrat më të mira për të treguar historitë tuaja. Sidoqoftë, në ditët e lira, shkëputuni nga puna. Merrni me atë që ju pëlqen: kaloni kohë me familjen ose miqtë, merrni me aktivitete fizike dhe fikni kompjuterin. Mund të dëshironi gjithashtu të krijoni një grup mbështetës mes kolegësh. Kur merreni vazhdimisht me viktimat të traumatizuara, do të përjetoni reagime emocionale. Zgjidhni dikë me të cilin mund të ndani ndjenjat tuaja, qoftë ky redaktor, koleg gazetar, anëtar i familjes apo mik i mirë. Kërkoni ndihmë profesionale nëse keni nevojë për të.

### 3.6 Raportimi në bashkëpunim

Raportimi në bashkëpunim mund të jetë një mjet i fortë në arsenalin tuaj për mbulimin e DhBGj-së dhe AVL-ve për një sërë arsyesh.

#### *Aksesi në ekspertizë të larmishme*

Çështjet e AVL-ve dhe DhBGj-së janë komplekse dhe shpesh ndërlidhen me politika, të drejtat e njeriut, zbatimin e ligjit dhe shëndetin publik. Raportimi në bashkëpunim u lejon gazetarëve që të bashkojnë ekspertizat e tyre në fusha të ndryshme, duke siguruar pasqyrimin e historisë në mënyrë të plotë. Për shembull, gazetari i specializuar në zonat e konfliktit mund të bashkëpunojë me ekspertin e DhBGj-së, për të vënë në dukje se si përhapja e armëve të zjarrit përshkallëzon dhunën ndaj grave. Bashkëpunimi me gazetarët vendës ose OJQ-të siguron aksesin në informacione për kontekste kulturore dhe ligjore, të cilat mund të jenë të vështira për t'u kuptuar plotësisht nga reporterët e jashtëm.

#### *Qasja e gjerë gjeografike*

Trafikimi i AVL-ve dhe DhBGj-ja janë shpesh çështje ndërkufitare, pasi rrugët e kontrabandimit të armëve kalojnë përtej kufijve, duke ndikuar rajone të shumta. Raportimi në bashkëpunim u mundëson gazetarëve të mbulojnë njëkohësisht tema të tilla nga vendndodhje të ndryshme, duke ofruar një qasje gjithëpërfshirëse të çështjes. Për shembull, një ekip mund të fokusohet te lëvizja e armëve nëpërmjet zonave të konfliktit në Afrikë, ndërsa një tjetër investigon mënyrën se si këto armë arrijnë grupet kriminale në Evropë. Kjo përhapje e gjerë gjeografike pasuron mbulimin e temës dhe tregon shkallën globale të problemit.

#### *Kapacitete më të forta investigative*

Raportimi në bashkëpunim kombinon burimet investigative të shumë gazetarëve ose organizatave të lajmeve, duke e bërë më të lehtë kryerjen e investigimeve të thella. Investigimi i tregtisë së paligjshme të armëve ose ekspozimi i mënyrës se si AVL-të kontribuojnë në DhBGj, shpesh kërkon qasje në të dhëna që janë të vështira për t'u siguruar, të tilla si të dhënat e trafikimit të armëve, çështjet gjyqësore ose dëshmitë e të mbijetuarve. Nëse punojnë së bashku, gazetarët ndajnë të dhëna, burime dhe kontakte, duke e bërë më të mundshëm zbulimin e rrjeteve dhe lidhjeve të fshehura.

#### *Risku dhe burimet e ndara*

Raportimi mbi tema të ndjeshme si AVL-të dhe DhBGj-ja mund të përfshijë rreziqe të konsiderueshme, veçanërisht kur investigohen rrjete të forta kriminale ose qeveri të përfshira. Bashkëpunimi u lejon gazetarëve të ndajnë barrën e këtyre rreziqeve, duke e bërë më të sigurt trajtimin e historive të ndjeshme. Burimet e përbashkëta financiare dhe teknike po ashtu mund të mbështesin një investigim më të thelluar, veçanërisht në rajonet ku gazetaria e pavarur është e pamjaftueshme ose e kufizuar.

#### *Rritja e ndikimit*

Raportimi në bashkëpunim mund të përforcojë shtrirjen dhe ndikimin e historive, duke u lejuar shumë media të publikojnë gjetjet njëkohësisht. Kjo qasje e koordinuar mund të sigurojë që historia të mbërrijë audienca të ndryshme dhe të ketë një ndikim më të madh në ndërgjegjësimin publik, diskutimet mbi politikën ose përpjekjet ndërkombëtare të advokimit. Në kontekstin e AVL-ve dhe DhBGj-së, një raportim i tillë i koordinuar mund të ushtrojë presion mbi qeveritë dhe organet ndërkombëtare që të veprojnë në lidhje me çështjet e kontrollit të armëve dhe dhunës me bazë gjinore.

Pra, tashmë jeni të bindur se dëshironi të ndiqni një projekt raportimi në bashkëpunim për DhBGj-në dhe AVL-të, por si do ta bëni? Cilat janë disa prej praktikave të mira? Këto janë disa prej strategjive kyç për bashkëpunim të suksesshëm.

#### *Përcaktoni role dhe përgjegjësi të qarta*

Që prej fillimit, sigurohuni që çdo gazetar ose anëtar i ekipit të kuptojë qartë rolin e vet në projekt. Disa anëtarë të ekipit mund të përqendrohen në mbledhjen e të dhënave, të tjerë në intervistat me të mbijetuarit dhe të tjerë në analizimin e politikave që lidhen me AVL-të. Ndarja e përgjegjësisë sipas ekspertizës jo vetëm që e përmirëson procesin, por gjithashtu siguron që projekti mbulon këndvështrime të ndryshme në mënyrë efikase.

#### *Krijoni një qendër bazë kërkimi dhe komunikimi*

Për projektet e kryera në bashkëpunim që përfshijnë gazetarë të shumtë, veçanërisht nga rajone ose organizata të ndryshme, është thelbësore të krijohet një platformë digjitale e centralizuar për komunikim, ndarje të skedarëve dhe përditësimeve. Mjete si Slack, Trello ose Google Workspace mund t'i ndihmojnë ekipet të ndajnë progresin në kohë reale, të japin reagime dhe të qëndrojnë në linjë me qëllimet e projektit. Kjo është veçanërisht e dobishme kur punohet në zona kohore ose rajone të ndryshme, si për shembull në mbulimin e çështjeve globale si AVL-të dhe DhBGj-ja.

#### *Shfrytëzoni ekspertizën lokale*

Kur raportoni mbi çështje ndërkombëtare të AVL-ve dhe DhBGj-së, bashkëpunoni me gazetarë, OJQ dhe avokatë vendës, që kuptojnë në mënyrë të thelluar kontekstin kulturor dhe atë ligjor. Ata mund t'ju ofrojnë njohuri të paçmueshme, t'ju ndihmojnë në lundrimin e traditave dhe zakoneve vendëse dhe t'ju lidhin me burime, që përndryshe mund të ishin të vështira për t'u aksesuar. Kjo qasje siguron që projekti të jetë i saktë dhe i ndjeshëm ndaj kulturës.

#### *Ndani të dhëna dhe burime*

Historitë e bazuara në të dhëna shpesh kërkojnë burime të konsiderueshme, nga qasja në bazat e të dhënave deri tek interpretimi i statistikave. Ndarja e burimeve, siç është qasja në të dhënat mbi fluksin e armëve ose statistikave të DhBGj-së, mund të sigurojë që çdo gazetar të ketë qasje në të njëjtin informacion bazë. Mjetet e bashkëpunimit si Datawrapper ose Flourish u lejojnë gazetarëve të shumtë të punojnë së bashku në vizualizimin e të dhënave, duke përmirësuar rrëfimin e historive.

#### *Sigurohuni për raportim etik dhe të mirinformuar për traumën*

Gjatë mbulimit të temave të ndjeshme si DhBGj-ja, të gjithë bashkëpunëtorët duhet të jenë në përputhje me udhëzimet etike. Diskutoni qasjet e bazuara në trauma për intervistimin e të mbijetuarve dhe trajtimin e materialeve të ndjeshme, duke u siguruar që të gjithë gazetarët të punojnë sipas të njëjtit kuadër etik për të mbrojtur dinjitetin dhe sigurinë e burimeve.

#### *Rregulloni kontrollet dhe boshllëqet në ofrimin e komenteve*

Caktoni takime të rregullta për të shqyrtuar progresin e bërë, diskutoni çdo sfidë dhe jepni komentet tuaja. Kjo e mban projektin në linjë dhe lejon për rregullime dhe ndryshime nëse dalin gjetje të reja. Komunikimi i vazhdueshëm siguron se të gjithë bashkëpunëtorët janë në linjë me narrativën dhe qëllimet e historisë.

#### *Bashkëpunoni nëpërmjet platformave*

Nëse projekti do të shpërndahet në media të shumta - si shtypi i shkruar, shtypi online dhe kanalet

televizive dhe radiofonike - sigurohuni që çdo format të jetë i optimizuar. Bashkëpunëtorët duhet të jenë të vetëdijshëm për nevojat e platformave të ndryshme dhe të punojnë së bashku për të përshtatur përmbajtjen për audiencat e ndryshme. Një qasje multimediale e cila kombinon raportet e shkruara, dokumentarë dhe këqyrje të të dhënave mund të zgjerojë shtrirjen dhe ndikimin e projektit.

#### *Konsideroni bashkautorësinë dhe ndarjen e meritave*

Në projektet në bashkëpunim, transparenca në lidhje me autorësinë dhe meritat është thelbësore. Diskutoni se si do të ndahen meritat midis anëtarëve të ekipit ose mediave, veçanërisht nëse media të ndryshme do të publikojnë pjesë të investigimit. Ofrimi i bashkautorësisë dhe meritave të përbashkëta siguron vlerësimin e punës së secilit kontribues dhe inkurajon bashkëpunimet e ardhshme.

### **3.7 Raste studimi**

Këto raste studimi ofrojnë shembuj konkretë se si gazetarët mund ta përballojnë detyrën komplekse dhe shpesh të rrezikshme të raportimit mbi AVL-të, sigurinë dhe dhunën me bazë gjinore. Çdo rast ofron njohuri mbi sfidat e hasura, strategjitë e përdorura dhe ndikimin që gazetaria rigoroze dhe etike mund të ketë në shoqëri.

#### **3.7.1 Rast studimi: Raportimi investigativ për trafikun e paligjshëm të armëve në Ballkan**

##### **Konteksti**

Një ekip gazetarësh investigativë nga Ballkani bashkëpunoi përtej kufijve për të zbuluar një rrjet kompleks të trafikimit të paligjshëm, që furnizonte me armë organizata kriminale në të gjithë Evropën. Puna e tyre përfshinte kërkime të gjera mbi të dhënat publike, gjurmimin e dërgesave të armëve dhe intervistimin e personave të brendshëm.

##### **Sfidat**

Gazetarët u përballën me rreziqe të konsiderueshme, përfshirë kërcënime për sigurinë e tyre dhe sfida ligjore nga ata të përfshirë në raportimet e tyre. Sfida të tjera ishin akseset e kufizuara në të dhëna zyrtare dhe nevoja për të mbrojtur burimet e ndjeshme.

##### **Rezultati**

Investigimi çoi në rritjen e kontrollit të tregtisë së armëve në rajon, duke nxitur masa qeveritare ndaj tregtarëve të paligjshëm të armëve dhe një shtrëngim të rregulloreve rreth eksportit të armëve. Seria e raportimeve u vlerësua gjithashtu me disa çmime ndërkombëtare gazetarie.

##### **Mësimet kyç**

- Rëndësia e bashkëpunimit ndërkufitar në trajtimin e çështjeve globale si trafikimi i armëve;
- Strategjia për mbrojtjen e burimeve dhe garantimin e sigurisë së gazetarëve në hetimet me rrezik të lartë;
- Roli i gazetarisë investigative në ndikimin e politikave dhe reformës ligjore.

### **3.7.2 Rast studimi: Raportimi në bashkëpunim për AVL-të dhe shkeljet e të drejtave të njeriut në Afrikë**

#### **Konteksti**

Një koalicion gazetarësh afrikanë punoi së bashku për të hetuar lidhjen midis përhapjes së AVL-ve dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut në zonat e konfliktit. Raportimi i tyre nxori në pah se si disponueshmëria e armëve të vogla e të lehta përkeqësoi dhunën ndaj civilëve, veçanërisht në rajonet me qeverisje të dobët.

#### **Sfidat**

Gazetarëve iu desh të vepronin në zona të rrezikshme të konfliktit, ku shpesh përballeshin me akses të kufizuar në informacion dhe komunikim të besueshëm. Ata gjithashtu u përballën me dilema etike në raportimin mbi dhunën, ndërkohë që garantonin sigurinë e komuniteteve të prekura.

#### **Rezultati**

Seria e raportimeve tërhoqi vëmendje ndërkombëtare, duke rritur mbështetjen për iniciativat e çarmatimit dhe presionin më të fortë ndërkombëtar mbi qeveritë për të kontrolluar fluksin e armëve. Raportimet gjithashtu nxitën diskutime globale rreth ndikimit humanitar të armëve të vogla dhe të lehta.

#### **Mësime kyç**

- Fuqia e raportimit në bashkëpunim për të hedhur dritë mbi çështje globale të nënraportuara;
- Si të përballohen sfidat etike në raportimin e konflikteve;
- Ndikimi i medias në formësimin e politikave ndërkombëtare dhe përgjigjeve humanitare.

### **3.7.3 Rast studimi: Ekspozimi i trafikut të qenieve njerëzore dhe dhunës me bazë gjinore në Azinë Juglindore**

#### **Konteksti**

Një grup gazetarësh nga Azia Juglindore u bashkuan me OJQ-të ndërkombëtare për të zbuluar lidhjen midis trafikimit të qenieve njerëzore dhe dhunës me bazë gjinore. Hetimi i tyre u përqendrua te mënyra se si gratë e trafikuar iu nënshtruan dhunës dhe shfrytëzimit të ashpër, duke pasur pak shpresë për t'u arratisur apo për të gjetur drejtësi.

#### **Sfidat**

Gazetarëve iu duhej të përballeshin me rreziqet e punës në rajone të kontrolluara nga trafikantë dhe zyrtarë të korruptuar. Atyre po ashtu iu desh të fitonin besimin e të mbijetuarve të trafikimit, shumë prej të cilëve ishin të traumatizuar dhe të frikësuar për dëme të mëtejshme. Përveç kësaj, hetimi kërkoi koordinim të gjerë me OJQ-të për të ofruar mbështetje për të mbijetuarit e shfaqur te kronika.

#### **Rezultati**

Raportimet tërhoqën vëmendje ndërkombëtare ndaj kësaj çështjeje, duke rritur përpjekjet e qeverive dhe organizatave ndërkombëtare për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore. Seriali i raportimeve gjithashtu ndihmoi në shpëtimin e disa viktimave dhe u ofroi atyre mbështetje ligjore dhe psikologjike. Ai u vlerësua në nivel global për kontributin e ofruar ndaj gazetarisë së të drejtave të njeriut.

### Mësime kyç

- Rëndësia e bashkëpunimit midis gazetarëve dhe OJQ-ve në trajtimin e çështjeve komplekse si trafikimi i qenieve njerëzore;
- Si të balancohet nevoja për raportim me ndikim me përgjegjësinë etike për të mbrojtur individët e cenueshëm;
- Roli i medias ndërkombëtare në amplifikimin e çështjeve lokale dhe nxitjen e veprimeve globale.

## Shtojca I Punët e cituara

Government of Albania (2020). *Law on Protection from Discrimination in Albania*. <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/04/Law-on-Protection-from-Discrimination-Albania.-2020.pdf>

Arsovska, J. (2019). The rise of Balkan organized crime. In M. Natarajan (Ed.), *International and transnational crime and justice* (pp. 198–203). Cambridge University Press.

Carapic, J. (2014). *Handgun Ownership and Armed Violence in the Western Balkans*. Small Arms Survey. <http://www.jstor.org/stable/resrep10623>

Constitution of Albania (2016) [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-REF\(2016\)064-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-REF(2016)064-e)

Council of Europe (2024). *GREVIO's First Thematic Evaluation Report on Albania: Building Trust by Delivering Support, Protection and Justice*. Available at [rm.coe.int](https://rm.coe.int).

Davis, J. (2016). A European gun culture deadlier than America's. *Politico*. January 18. Accessed November 26, 2024. <https://www.politico.eu/article/the-european-nation-with-a-deadlier-gun-culture-than-the-us-albania/>.

European Centre for Press and Media Freedom. (2023). *Defending Media Freedom and Journalists' Safety in Albania*. July 19. <https://www.ecpmf.eu/defending-media-freedom-and-journalists-safety-in-albania/>

European Commission (2023). *Accompanying the communication on EU enlargement policy*. Commission staff working document. [SWD(2023) 690 final]. Available at: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/COM\\_2023\\_690%20Communication%20on%20EU%20Enlargement%20Policy\\_and\\_Annex.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/COM_2023_690%20Communication%20on%20EU%20Enlargement%20Policy_and_Annex.pdf)

European Commission (2020). *Accompanying the communication on EU enlargement policy*. Commission staff working document. [SWD(2020) 354 final]. Available at: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf).

Gender Alliance for Development Center (GADC). (2021). *Newsletter: Roundtable on GBV and women's rights in Albania*. Retrieved from [https://www.gadc.org.al/media/files/upload/GADC\\_Newsletter\\_Round%20Table\\_June%202,%202021.pdf](https://www.gadc.org.al/media/files/upload/GADC_Newsletter_Round%20Table_June%202,%202021.pdf)

Global Initiative Against Transnational Organized Crime (2021). *Unburying guns from Albania's past*. *Risk Bulletin* #7, April-May 2021. Accessed November 27, 2024. <https://riskbulletins.globalinitiative.net/see-obs-007/05-unburying-guns-from-albanias-past.html>.

Global Initiative Against Transnational Organized Crime (2020). *Illicit Financial Flows in Albania, Kosovo and North Macedonia: Key Drivers and Current Trends*. August 2020. <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2020/08/IFFs-Balkans-English-WEB-Nov2020-1.pdf>

Holtom, P., Smith, H., Mariani, B., Rynn, S., Attree, L., & Sokolová, J. (2005). Turning the page: Small arms and light weapons in Albania. *Report on Small Arms and Security in South Eastern Europe, Center for Peace and Disarmament Education and Saferworld*. Retrieved November 29, 2024, from <https://gsdrc.org/document-library/turning-the-page-small-arms-and-light-weapons-in-albania/>

Network Against Gender-Based Violence (2024). *Monitoring Report on Gender-Based Violence in Albania*, pp. 8-9. Available at: [https://rrjetikunderdhunesgjinore-monitorime.al/en/wp-content/uploads/2024/05/Report\\_per-publikim.pdf](https://rrjetikunderdhunesgjinore-monitorime.al/en/wp-content/uploads/2024/05/Report_per-publikim.pdf)

OSCE Presence in Albania (2023). *Presentation of awareness raising and communication strategy, action plan and campaign on small arms and light weapons*. June 6. Accessed November 24, 2024.

[https://www.osce.org/presence-in-albania/545473#\\_ftn1](https://www.osce.org/presence-in-albania/545473#_ftn1)

OSCE Presence in Albania (2024). Journalists' Needs Assessment (unpublished).

OC Index. (2023). *Global Organized Crime Index*. Accessed November 24, 2024. <https://ocindex.net/2023/country/albania>.

ReliefWeb (2002). Albania, Kosovo and Macedonia: Armed to the teeth. August 5. Retrieved from <https://reliefweb.int/report/albania/albania-kosovo-and-macedonia-armed-teeth>

Rusi, I. (2012). The Albanian legal framework on non-discrimination and gender equality in employment relationships. *Academicus International Scientific Journal*, 3(5), 131–142. <https://doi.org/10.7336/academicus.2012.05.12>

SEESAC. (2019). *Small Arms and Light Weapons, Their Ammunition and Explosives Control Strategy, 2019-2024, Albania*. Accessed November 24, 2024. [https://www.seesac.org/f/docs/Albania-1/ENG\\_Albanian\\_Strategy\\_on\\_Firearms\\_Control-24-06-2019.pdf](https://www.seesac.org/f/docs/Albania-1/ENG_Albanian_Strategy_on_Firearms_Control-24-06-2019.pdf).

SEESAC (2019a). *Small Arms and Light Weapons (SALW) Survey: Albania 2012 – 2016*. Accessed November 25, 2024. [https://www.seesac.org/f/docs/SALW-Surveys/web\\_Albania-SALW-Survey\\_ENG.pdf](https://www.seesac.org/f/docs/SALW-Surveys/web_Albania-SALW-Survey_ENG.pdf)

SEESAC (2019b). *Gender and Small Arms in Albania*. [https://www.seesac.org/f/docs/Gender-and-SALW/Gender-And-Small-Arms\\_ALBANIA\\_ENG\\_WEB\\_1.pdf](https://www.seesac.org/f/docs/Gender-and-SALW/Gender-And-Small-Arms_ALBANIA_ENG_WEB_1.pdf)

SEESAC (2019c). *Roadmap for a Sustainable Solution to the Illegal Possession, Misuse and Trafficking of Small Arms and Light Weapons (SALW) and Their Ammunition in the Western Balkans by 2024*. September 27. Accessed November 24, 2024. <https://www.seesac.org/f/docs/publications-salw-control-roadmap/Regional-Roadmap-for-a-sustainable-solution-to-the.pdf>

SEESAC (2019d). *Small Arms, Light Weapons and Explosives Control Strategy 2019-2024 and Its Action Plan 2019-2021*. [https://www.seesac.org/f/docs/Albania-1/ENG\\_Albanian\\_Strategy\\_on\\_Firearms\\_Control-24-06-2019.pdf](https://www.seesac.org/f/docs/Albania-1/ENG_Albanian_Strategy_on_Firearms_Control-24-06-2019.pdf)

SEESAC (2021). *Gender Analysis Report of Small Arms Control Legal and Policy Frameworks in the Republic of Albania*. [https://www.seesac.org/f/docs/Gender-and-SALW/Gender-Analysis-Report\\_ALBANIA.pdf](https://www.seesac.org/f/docs/Gender-and-SALW/Gender-Analysis-Report_ALBANIA.pdf)

UNDP (2023). *Western Balkans SALW Control Roadmap MPTF Project Document*. Available at: [https://mptf.undp.org/sites/default/files/documents/2023-10/prodoc\\_rev\\_gtw\\_231003\\_0.pdf](https://mptf.undp.org/sites/default/files/documents/2023-10/prodoc_rev_gtw_231003_0.pdf).

UNDP (2019). *National population survey on violence against women and girls in Albania*. United Nations Development Programme. Retrieved from <https://www.undp.org/albania/publications/national-population-survey-violence-against-women-and-girls-albania>

UNDP Albania. *Project Support Albania's Law Enforcement Authorities to Strengthen Firearms Criminality Evidence Management and Investigation Capacities*. United Nations Development Programme (UNDP). Accessed November 24, 2024. <https://www.undp.org/albania/projects/support-albanias-law-enforcement-authorities-strengthen-firearms-criminality-evidence-management-and-investigation-capacities>

UNDP Albania. *Strengthening Control, Administration and Social Attitudes Towards SALW*. United Nations Development Programme (UNDP). <https://www.undp.org/albania/projects/strengthening-control-administration-and-social-attitudes-towards-salw>

Zhilla, F., & Lamallari, B. (2015). Organized crime: Threat assessment in Albania. *Open Society Foundation for Albania*. <https://doi.org/10.13140/RG.2.1.3825.6481>

## Shtojcë II Burime shitesë

Government of Albania. *The Official Publishing Center* (Albanian: Qendra e Botimeve Zyrtare – QBZ). <https://www.qbz.gov.al/>

Amnesty International (2006). *Violence against women in the family: It's not her shame*. <https://www.amnesty.org/en/wp-content/uploads/2021/08/eur110022006en.pdf>

Davies, J. (2016). "A European Gun Culture Deadlier Than America's". *Politico*. <https://www.politico.eu/article/the-european-nation-with-a-deadlier-gun-culture-than-the-us-albania/>

DeBlieck, S. (2009). *Monitoring and Evaluation Arrangements for the Support to Security Sector Reform Programme in Albania: A Case Study*. January. <https://file:///Users/gogath/Downloads/AlbaniaCaseStudy.pdf>

Global Initiative Against Transnational Organized Crime (2017). *Crooked Kaleidoscope: Organized Crime in the Balkans*. June. [https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2017/07/OC\\_balkans.pdf](https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2017/07/OC_balkans.pdf)

Global Initiative Against Transnational Organized Crime (2024). *The Western Balkans Is Still the Criminals' Choice for Weapons*. <https://riskbulletins.globalinitiative.net/see-obs-018/04-western-balkans-still-criminals-choice-weapons.html>

Global Initiative Against Transnational Organized Crime (2021). *Unburying Guns from Albania's Past*. <https://riskbulletins.globalinitiative.net/see-obs-007/05-unburying-guns-from-albanias-past.html>

Regional Co-operation Council (RCC) (2023). *Kapetanovic: With Already 334 Victims of Firearms in 2023 in Our Region, It Is High Time to Reduce Its Supply, Demand and Misuse*. June 23. <https://www.rcc.int/news/824/kapetanovic-with-already-334-victims-of-firearms-in-2023-in-our-region-it-is-high-time-to-reduce-its-supply-demand-and-misuse>

Ruvina, L. (2017). *Arms Up, Guns Down: Analyzing the Clash between the Narratives of State and Media Actors on Light Weapons Control in Albania*. [https://brucol.be/files/articles/ejis\\_v5\\_i1\\_19/Ruvina.pdf](https://brucol.be/files/articles/ejis_v5_i1_19/Ruvina.pdf)

Saferworld (2006). *Small Arms Survey of Albania*. January 15. <https://www.saferworld-global.org/resources/news-and-analysis/post/225-small-arms-survey-of-albania>

Sinoruka, F. (2021). "Albania Looks for Answers to Rising Trend of Gun Violence". *Balkan Insight*. December 22. <https://balkaninsight.com/2021/12/22/albania-looks-for-answers-to-rising-trend-of-gun-violence/>

Taylor, A. (2021). "Gun Deaths and Crime on the Rise in Albania, Men Aged 19-35 Most Likely to Offend". *Exit*. July 21. <https://exit.al/en/gun-deaths-and-crime-on-the-rise-in-albania-men-aged-19-35-most-likely-to-offend/>

UNDP (2018). *The Western Balkans SALW Control Roadmap Multi-Partner Trust Fund*. [https://mptf.undp.org/sites/default/files/documents/final\\_tor\\_salw\\_western\\_balkans.pdf](https://mptf.undp.org/sites/default/files/documents/final_tor_salw_western_balkans.pdf)

UNDP (2019). *Research brief: Violence against women and girls in Albania, including those involving firearms*. <https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/al/Research-Brief-VAW.pdf>

UNODC. *Country Data. United Nations Office on Drugs and Crime (UNODC)*. <https://dataunodc.un.org/content/country-list>

## Burime lokale

Ka një larmi organizatash të drejtave të njeriut dhe OJF-ve që punojnë në këtë fushë. Këto janë disa prej këtyre burimeve lokale.

**Rrjeti i Fuqizimit të Grave Shqiptare (AWEN)** E themeluar në 2009-ën, AWEN është një rrjet kombëtar i përbërë nga tetë organizata jofitimprurëse që merren me të drejtat e grave dhe punojnë me njëra-tjetrën për fuqizimin social, ekonomik dhe politik të vajzave dhe grave që të marrin pjesë dhe t'i realizojnë këto të drejta [<http://www.awenetwork.org>].

**Avokati i Popullit** [<https://www.avokatipopullit.gov.al>]

**Komisioneri për Mbrojtje nga Diskriminimi** [<https://www.kmd.al/>]

Raportet e **Departamentit të Shtetit të SHBA-ve** për praktikën e të drejtave të njeriut: Shqipëria [<https://www.state.gov/reports/2023-country-reports-on-human-rights-practices/>].

**Komiteti Shqiptar i Helsinkit (AHC)** raporton për prevalencën e dhunës në familje dhe përdorimin e armëve të zjarrit nga këto incidente. [<https://ahc.org.al/en/>].

**Zyra UN Women Albania** ka qenë e përfshirë në mënyrë aktive në adresimin e dhunës me bazë gjinore, përfshirë ndikimin e AVL-ve në sigurinë e grave. [<https://albania.unwomen.org/en>].

**Anketa Kombëtare e Popullsisë 2018:** Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave në Shqipëri nga INSTAT-i dhe UN Women [<https://data.unwomen.org/publications/national-population-survey-2018-violence-against-women-and-girls-albania>]

**Anketa e Dhunës në Familje 2013** nga INSTAT-i dhe UNDP-ja. [<https://www.instat.gov.al/en/about-us/activities/other/domestic-violence-survey-2013/>]

**Qendra Streha** [<https://www.strehacenter.org>]

**Albanian Women in Audiovisual** [Shikoni këtu: <https://albanianwomaninaudiovisual.com>]

**Fondacioni Ndhmë për Fëmijët** [<https://www.facebook.com/ndihmeperfemijet>]

**Open Mind Spectrum Albania (OMSA)** [<https://resourcecentre.al/sq/directory-dir-cso/listing/open-mind-spectrum-albania-omsa>]

**Qendra Psikosociale Vatra** [<https://qendravatra.org.al>]

**Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin** [<https://acpd.org.al>]

**Qendra “Të Drejtat e Njeriut në Demokraci” (QDNJD)** [<https://www.hrdc.al/index.php/en>]

**Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim** [<https://www.gadc.org.al>]

**Shoqata Kombëtare Shqiptare e Njerëzve që nuk Dëgjojnë** [<https://smartbalkansproject.org/grants/albanian-national-association-of-the-deaf>]

**Shoqata Gender, Paqe e Siguri** [<https://www.siguria-paqja.al>]

**Të Ndryshëm & Të Barabartë** [<https://differentandequal.org/en>]

Për informacion të mëtejshëm në organizatat e të drejtave të njeriut dhe OJQ-të, konsultohuni me Qendrën Kombëtare Burimore për Shoqëri Civile në Shqipëri, një platformë informacioni dhe ofrimi shërbimi, që kontribuon në fuqizimin e kapaciteteve të shoqërisë civile për të qenë më efektive, transparente, me më shumë llogaridhënie dhe aktorë të pavarur për krijimin e një ambienti për shoqërinë civile, pjesëmarrje në demokraci dhe procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Platforma menaxhohet nga partnerët e Shqipërisë: Qendra Kombëtare Burimore për Shoqëri Civile në Shqipëri

## Organizata

**Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM):** E vendosur në Tiranë, IDM-ja zhvillon hulumtime në reformën e sektorit të sigurisë, qeverisjes dhe rolit të shoqërisë civile në Shqipëri. Puna e tyre shpesh kryqëzohet me çështjet e kontrollit të armëve dhe sigurisë së komunitetit. [<https://idmalbania.org>]

**Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare (AIIS):** Institut joqeveritar, jofitimprurës kërkimor dhe politikash, i cili ofron analiza të detajuara për marrëdhëniet ndërkombëtare të Shqipërisë në politikat e sigurisë dhe çështje të mbrojtjes. [<https://www.aiis-albania.org>]

**Qendra për Studime të Evropës Juglindore (CSEES):** Angazhohet në kërkime dhe analiza politikash në reformën e sektorit të sigurisë, qeverisjes dhe rolin e shoqërisë civile në Evropën Juglindore, përfshirë Shqipërinë. [<https://wbc-rti.info/object/organisation/16844.html>]

## Ekspertë

**Jana Arsovska, PhD:** “Profesor i Asociuar” në Kolegjin e Drejtësisë Penale John Jay, e cila mban doktoraturë në Kriminologji. Ka kryer studime të gjera për krimin e organizuar në Shqipëri, me tema kërkimore që përfshijnë krimin e organizuar, korrupsionin dhe shkelëset femra. Puna e saj ofron informacion të qenësishëm për studime të lidhura me kriminologjinë dhe sigurinë në Shqipëri [<https://www.jjay.cuny.edu/faculty/jana-arsovska>]

**Fabian Zhilla, PhD:** Studiues-vizitues Fulbright në Qendrën për Studime Evropiane në Universitetin e Harvardit dhe lektor për Drejtësi dhe Etikë në Institutin Kanadez të Teknologjisë në Shqipëri. Drejton Njësinë Kërkimore “Studime të Krimin të Organizuar” tek Fondacioni i Shoqërisë së Hapur në Shqipëri. Studimet e tij përqendrohen në krimin e organizuar, krimin financiar, krimin kibernetik dhe terrorizmin në Ballkanin Perëndimor, ndërsa i kushtohet vëmendje ndërlidhjes mes krimin të organizuar dhe aktorëve joqeveritarë në demokracitë e reja. [<https://globalinitiative.net/profile/fabian-zhilla>]

**Blendi Kajsiu, PhD:** Profesor i Asociuar në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Politike në Universitetin e Antioquia, Medellin, Kolumbi. Ka përfunduar studimet doktorale në Ideologji dhe Analizë të Diskursit nga Universiteti i Eksesit, Mbretëri e Bashkuar. Kërkimet e tij mbulojnë diskursin për antikorrupsionin, populizmin, ideologjinë dhe politikat në Shqipëri dhe Kolumbi. [<https://independent.academia.edu/BLENDIKAJSIU>]

**Iris Luarasi, PhD:** Akademike dhe hulumtuese shqiptare e specializuar në çështje që lidhen me barazinë gjinore, të drejtat e grave dhe drejtësinë sociale. Shquhet për punën e saj në studimet gjinore dhe ka kontribuar në zhvillimin e politikave dhe programeve të përqendruara të DhBGj-ja dhe fuqizimi i grave në Shqipëri. [<https://gov-al.academia.edu/IrisLuarasi>]

**Agron Sojati:** Ekspert shqiptar i shquar në fushën e sigurisë, zbatimit të ligjit dhe qeverisjes. Ka mbajtur pozicione kyç në reformën e sektorit të sigurisë, kundërterrorizmin dhe bashkëpunimin rajonal dhe ka marrë pjesë në iniciativa që adresojnë kontrollin e AVL-ve në Shqipëri dhe Ballkanin Perëndimor. [<https://wb-iisg.com/staff/agron-sojati-head-of-iisg-secretariat>]

**Besfort Lamallari:** Zëvendësministër i Brendshëm që prej tetorit të 2017-ës, Lamallari është një kriminolog i cili ka përfunduar studimet Master Shkencash në Kriminologji dhe Drejtësi Penale në Universitetin e Oksfordit. Hulumtimet e tij përfshijnë krimin e organizuar, trafikun e qenieve njerëzore dhe shkencën kriminale, me kontribute në *Radikalizmin Fetar dhe Ekstremizmin e Dhunshëm në Shqipëri*. [<https://www.researchgate.net/profile/Besfort-Lamallari>]

**Agustela Nini-Pavli:** Hulumtuese me eksperiencë të konsiderueshme në barazinë gjinore, u ofron këshillim teknik qeverive për zhvillimin e strategjive dhe përmirësimin e legjislationit. Ka punuar gjerësisht me UN Women, duke kontribuar me ekspertizën e saj në integrimin gjinor dhe reformën ligjore, **përfshirë strategjitë për luftën kundër DhBGj**-së e promovimin e të drejtave të grave [<https://albania.unwomen.org/en/news-and-events/stories/2017/09/experts-take-agustela-nini-pavli-form-un-women>]

**Albert Rakipi, PhD:** Drejtues Ekzekutiv i AIIIS, Rakipi është ekspert i marrëdhënieve ndërkombëtare, studimeve të sigurisë dhe qeverisjes. Puna e tij përqendrohet në politikën e jashtme të Shqipërisë, bashkëpunimin rajonal dhe integrimin e Shqipërisë në strukturat euroatlantike. [<https://www.aiis-albania.org/?q=node/42>]

**Dr. Elton Skëndaj:** Akademik i specializuar në demokratizim, ndërtim të shteteve dhe qeverisje në Evropën Juglindore. Ka përfunduar studimet doktorale për Qeverisje nga Universiteti i Kornellit dhe bërë hulumtime për rolin e aktorëve ndërkombëtarë në rritjen e demokracisë në shoqëritë postkonfliktuale. [<https://eltonskendaj.com>]

**Enika Abazi, PhD:** Hulumtuese në marrëdhëniet ndërkombëtare, studimet e sigurisë dhe gjeopolitikën rajonale të Ballkanit Perëndimor. Puna e saj përfshin studime në ndërtimin e shteteve, dinamikat rajonale të sigurisë dhe zgjidhjen e konflikteve në shoqëritë postkonfliktuale. [<https://cv.hal.science/enika-abazi>]

Faqe Interneti dhe Burime:

- Qendra për Paqe dhe Edukim Çarmatimi: [www.cpde.net](http://www.cpde.net)
- Saferworld: [www.saferworld.org.uk](http://www.saferworld.org.uk)
- Qendra për Studime të Evropës Juglindore: <http://www.csees.net>
- Këshilli për Pajtim Mbarëkombëtar: [www.pajtimi.com](http://www.pajtimi.com)
- Instituti për Raportim të Luftës dhe Paqes: Raporte për Krizën e Ballkanit: <http://www.iwpr.net/>
- Databazat NISAT: [www.nisat.org](http://www.nisat.org)
- Transparency International (Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit): <https://www.transparency.org>





